



ALBANIAN UNIVERSITY

RAPORT VETËVLERËSIMI PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL PERIODIK

GRUPI I VETËVLERËSIMIT:

1. Dr. Erda Qorri	Kryetar	Firma
2. Prof. Asoc. Aida Dama	Anëtar	Firma
3. Dr. Desara Agaj	Anëtar	Firma
4. Dr. Genta Rexha	Anëtar	Firma
5. MSc. Sidita Çoniku	Anëtar	Firma
6. Anxhela Kastrioti	Anëtar (Student)	Firma

Korrik 2019

Përmbajtja

1.	Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit.....	4
2.	Historiku i Albanian University.....	5
Rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 90, datë 20.10.2017 për Akreditimin Institucional të Albanian University dhe plotësimi i tyre nga Institucioni.....		
3.	Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional.....	10
	1 – Fusha e vlerësimit: Organizimi dhe menaxhimi i Institucionit	10
	2 – Fusha e vlerësimit: Burimet	16
	3 – Fusha e vlerësimit: Kurrikula	26
	4 - Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi	33
	5 – Fushat e vlerësimit: Studentët dhe mbështetja e tyre	41
	Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm.....	49
4.	Lista e evidencave mbështetëse të RVB – Albanian University.....	50

SHKURTESA

1. AU Albanian University
2. QAA Quality Assurance Agency (Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë)
3. ASCAL Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
4. GVB Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
5. APAAL Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
6. BA Bordi i Akreditimit
7. VBA Vendim i Bordit të Akreditimit
8. VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
9. ZZHK Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave
10. KKM Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin
11. RSH Republika e Shqipërisë
12. NJSBC Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
13. ZKKSHBA Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike
14. KSAU Këshilli Studentor Albanian University
15. MASR Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
16. KSH Kërkim Shkencor

1. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Albanian University (AU) ka kaluar akreditimin e parë Institucional nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (QAA) në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë (ASCAL), me Vendim Bordi Akreditimi Nr. 90, dt. 20.10.2017 me një kohëzgjatje vlefshmërie 2 vjeçare. Në fillim të vitit akademik 2018-2019, *Albanian University* ka aplikuar pranë ASCAL me shkresë Nr.310/1 Prot, dt. 26.10.2018 për fillimin e procedurave të akreditimit institucional periodik.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është ngritur me vendim të Senati Akademik Nr. 15 datë 15.05.2019.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, mundësitë për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperiencat të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga 6 anëtarë, një prej të cilëve është student.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësisish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi në punën e tij ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të AU, statutin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Grupit i janë vënë në dispozicion të gjitha të dhënat statistikore, raportet dhe dokumentacioni i punës së strukturave akademike dhe administrative të institucionit, të cilat janë përfshirë në këtë raport.

2. Historiku i Albanian University

Albanian University është pjesë e shoqërisë “UFO SHPK” themeluar në datë 25/05/1994, dhe regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me Numër Unik të Identifikimit J82025002B - Numri i Niptit.

Albanian University është një institucion privat i Arsimit të Lartë, themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004, “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO dental”. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.5.2009, emërtimi i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental” ndryshon në “UFO University”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 24.8.2011 u vendos ndryshimi i emrit të universitetit privat nga “UFO University” në “Albanian University”.

AU i hapi dyert në vitin akademik 2004 - 2005, me kursin e parë të studimeve në Stomatologji, me rreth 100 studentë. Që në vitin e parë të krijimit të tij, Institucioni vendosi në qendër të jetës akademike promovimin e produktit intelektual dhe shkrirjen e mësimdhënies me kërkimin shkencor, e finalizuar edhe me Konferencën e Parë Stomatologjike “UFO Dental”, e cila hapi siparin e një tradite tashmë të konsoliduar. Në vitin akademik 2005 – 2006, institucioni ofroi diploma universitare dhe në degë të tjera: Farmaci, Arkitekturë, Shkenca Juridike dhe Shkenca Politike. Disa nga elementët mbi të cilët u zhvillua Universiteti janë programe bashkëkohore studimi, staf me një formim shumë të gjatë si akademik dhe profesional, kushte infrastrukturore moderne dhe cilësore etj. Në vitin akademik 2006 - 2007, Universiteti u plotësua me tetë degë studimi: Stomatologji, Farmaci, Arkitekturë, Financë-Bankë, Shkenca Juridike, Shkenca Politike, Psikologji, Shkenca Komunikimi, dhe pranë tij ndoqën studimet rreth 2000 studentë. Në këtë vit akademik, përveç plotësimit të detyrave akademike, Universiteti vuri theksin në përfshirjen e akademikëve në debatet dhe çështjet publike. Takimet dhe debatet mbi çështjet e legalizimit të lobimit dhe evidentimit të grupeve të interesit, ishin hapi i parë drejt të qenit faktor në jetën publike të vendit. Forumet, *workshop*-et, seminarët, konferencat, debatet kanë përfshirë jo vetëm akademikët, por edhe studentët, si dhe grupet e interesit, konsideruar si pjesë e formimit intelektual drejt realizimit të misionit të Universitetit. Në prill të vitit 2007, përveç UFO Press, Universiteti zgjeron hapësirën e tij publike nëpërmjet televizionit “UFO Education” (tashmë UTV News). Ai u ideua si një televizion edukativ në çdo informacion që

transmeton. Synimi i tij ishte dhe është formimi kulturor në aspektet politike, artistike, letrare, duke u përpjekur të transmetojë vlerat më pozitive të shoqërisë globale. Viti akademik 2008 - 2009, erdhi me prova të reja për Universitetin. Në këtë vit akademik, universiteti u përball me sfida të reja duke ofruar programe të reja të nivelit të dytë dhe të tretë, të cilët mundësojnë profilizimin dhe specializimin e mëtejshëm të studentëve të tij, për t'i afruar sa më shumë me tregun e punës. Viti akademik 2009-2010, ishte viti i konsolidimit cilësor të Universitetit. Gjatë këtij viti, të gjitha programet *Bachelor* dhe programet e integruara si: Farmaci, Stomatologji dhe Arkitekturë, kaluan procesin e akreditimit dhe në vitin 2010 u vlerësuan pozitivisht nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Viti akademik 2011-2012, shënon një vit tjetër të rëndësishëm në jetën akademike të Universitetit, sepse në këtë vit akademik hapet cikli i tretë i studimeve: ai i specializimeve afatgjata në fushën e Stomatologjisë me 8 drejtime. Në këtë kuadër vlen për t'u theksuar zhvillimi i lëndëve të praktikës me profesorë të huaj. Ky vit shënon edhe një numër të madh aktivitesh shkencore dhe kulturore në të gjithë departamentet e Fakultetit të Mjekësisë, të pasqyruara edhe në revistën "Optime", si dhe një numër i madh botimesh të reja dhe ribotimesh të shtëpisë botuese "UFO Press". Viti akademik 2012-2013, përbën një vit të rëndësishëm sepse shënon 10 vjetorin e hapjes së aktivitetit të shërbimit privat në fushën e arsimit. Ky vit ofroi edhe një gamë më të gjerë programesh të ciklit të dytë, Master Profesional në fushën e Infermierisë dhe të Psikologjisë, sikurse edhe hapjen e programeve të ciklit të tretë "Doktoratë" në fushën e shkencave juridike, ekonomike, psikologji, shkenca politike, shkenca farmaceutike dhe arkitekturë.

Në vitet e fundit AU i ka dhënë prioritet konsolidimit të cilësisë së zhvillimit të veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe përvojat më të mira brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, gjatë 2 viteve të fundit, të gjitha programet e studimit që AU ofron janë rishikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe kanë kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm nga ASCAL dhe janë vlerësuar pozitivisht nga BA.

Albanian University është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.90, dt. 20.10.2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në bashkëpunim me QAA (Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë). Mbarëvajtja e këtij procesi periodik dhe realizimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi është në qendër të veprimtarisë së Institucionit.

REKOMANDIMET E LËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT ME VENDIM NR. 90,
DATË 20.10.2017 PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL TË ALBANIAN
UNIVERSITY DHE PLOTËSIMI I TYRE NGA INSTITUCIONI

Pas njohjes me Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA Nr. 90, datë 20.10.2017) “Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat, Albanian University” (AU), Senati Akademik i Albanian University, në mbledhjen e tij të datës 09.11.2017 ka diskutuar me përgjegjshmëri të lartë lidhur me angazhimin e strukturave të tij, për të përmbushur rekomandimet e mëposhtme të lëna nga Bordi i Akreditimit.

1. Institucioni të marrë masa të menjëhershme duke rekrutuar staf akademik efektiv dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e tij, duke analizuar me përgjegjësi pasojat që ka largimi dhe ndryshimet e vazhdueshme të këtij stafi veçanërisht në 3 vitet e fundit, në përmbushjen e standardeve të cilësisë.
2. Institucioni duhet të marrë hapa konkretë përmirësues për të siguruar cilësinë e duhur të programeve të studimit, për përfundimin dhe diplomimin e studentëve të regjistruar në këtë institucion.
3. Institucioni duhet të hartojë një strategji të posaçme për zhvillimin dhe zbatimin e kërkimit shkencor dhe të hartojë një plan veprimi për implementimin e saj.
4. Institucioni duhet të zbatojë përmes veprimeve konkrete, fushat që përbëjnë prioritetet për kërkimin shkencor.

Rektorati i Albanian University, në mbledhjen e datës 15.11.2017, zhvilluar bashkë me Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional si dhe me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, diskutoi mbi hapat konkretë që do të ndërmerren në këtë kuadër dhe filloi punën për përgatitjen e një plan veprimi për përmbushjen e rekomandimeve. Ky plan veprimi u miratua me Vendim Senati Akademik Nr. 24, Datë 13.12.2017, dhe implementimi i tij gjatë kësaj periudhe paraqitet si më poshtë vijon:

1. Institucioni të marrë masa të menjëhershme duke rekrutuar staf akademik efektiv dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e tij, duke analizuar me përgjegjësi pasojat që ka largimi dhe ndryshimet e vazhdueshme të këtij stafi veçanërisht në 3 vitet e fundit, në përmbushjen e standardeve të cilësisë.

- Albanian University ka vendosur shpalljen e thirrjes për vendet vakante për personel akademik efektiv, jo vetëm në fillim të vitit akademik (procedurë e ndjekur kjo prej vitesh në Institucion) por edhe përpara fillimit të semestrit të dytë të vitit akademik. Më konkretisht, thirrja është shpallur në muajin dhjetor për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 dhe procedura e ndjekur për rekrutim është realizuar konform akteve normative në fuqi në Institucion. Për më shumë informacion klikoni në linkun: <http://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante/>. (Evidencë R.1.a)
- Zyra e burimeve njerëzore, AU në bashkëpunim me zyrën juridike kanë rishikuar paraprakisht përmbajtjen e kontratave të punës së stafit akademik me kohë të plotë

(PAE) si dhe me Kontratë (PAK) në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 si dhe Kodin e Punës, në Republikën e Shqipërisë për vitin akademik 2017-2018. Kjo masë e marrë do të përmirësojë qëndrueshmërinë e stafit në këtë Institucion. Më konkretisht, në kontrata ndryshimet konsistojnë në:

- E drejta e stafit me kohë të plotë për të kërkuar një financim nga Albanian University për një aktivitet shkencor brenda ose jashtë vendit ose botim shkencor në fushën që përbën prioritet për njësinë bazë përkatëse. (*Evidencë R.1.b*)
- Të drejtën e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabatik një herë në shtatë vjet me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik.
- Për kategorinë Profesor dhe Lektor (PAK) është përcaktuar kohëzgjatja pa afat e kontratës së punës, me të drejtë ripërsëritjeje çdo vit në momentin e paraqitjes së lejes nga punëdhënësi. (*Evidenca R.1.c*)
- Institucioni për herë të parë në muajin Dhjetor 2018 ka implementuar një pyetësor drejtuar personelit akademik të AU me qëllim marrjen e feedback-ut në lidhje me eksperiencën e tij në Albanian University, duke u fokusuar në çështje të tilla si: aspekti personal, paga dhe kushtet, politikat e universitetit, ambienti i punës, mësimdhënia, institucioni, studentët dhe departamenti, puna kërkimore – shkencore, etj. Pyetësi është plotësuar elektronikisht duke ruajtur anonimatit e personit që e plotëson. Rezultatet e pyetësorit mbështesin analizën e qëndrueshmërisë në punë të stafit. Për më shumë informacion referojuni bookletit me analizën e pyetësorit drejtuar personelit akademik. (*Evidencës R.1.d*)
- Zhvillimin e mëtejshëm të procedurave mbi mobilitetin e lektorëve të Albanian University pranë Universiteteve të tjera të huaja dhe anasjelltas bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që Albanian University ka me këto Institucione Aktualisht, Albanian University është duke zgjeruar aplikimet për mobilitet të profesorëve apo lektorëve, me qëllim kualifikimin dhe motivimin e mëtejshëm të stafit akademik me performancë të lartë. Nga kjo lëvizje kanë përfituar mobilitet 13 anëtarë të personelit akademik gjatë 2 viteve të fundit. (*Evidenca R.1.e*).
- *Albanian University* ka realizuar një analizë mbi qëndrueshmërinë e stafit të angazhuar pranë tij, bazuar në fillimin dhe kohëzgjatjen e bashkëpunimit me të dhe në bazë të kësaj analize rezultati tregon për një qëndrueshmëri të stafit. Për më shumë informacion bashkëngjitur gjeni analizën statistikore (*Evidenca R.1.f*).

2. Institucioni duhet të marrë hapa konkretë përmirësues për të siguruar cilësinë e duhur të programeve të studimit, për përfundimin dhe diplomimin e studentëve të regjistruar në këtë institucion.

Në AU sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm, i cili inicion me:

- Rekrutimin e stafit akademik me grada shkencore e tituj akademik dhe me eksperiencë të gjatë në profilin përkatës; (*Evidencë R.1.a*)
- Vazhdon me trajnimin e stafit akademik çdo fillim viti me profesorë nga universitetet të huaja me qëllim ofrimin e një mësimdhënie të standardeve bashkëkohore ku në qendër është gjithmonë studenti dhe nxitja e mendimit të tij kritik; (*Evidencë R.2.a*)
- Rishikimin e kurrikulave çdo vit akademik dhe syllabuseve me qëllim përditësimin e literaturës. Konkretisht, këtë vit akademik në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi por edhe me kërkesat e tregut të punës vendas dhe me gjerë janë rishikuar të gjitha programet e studimit të cilat kanë marrë miratimin nga Ministria përgjegjëse për Arsimin. (*Evidencë R.2.b*)
- Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në AU, në fokus është dhe procesi i ndërkombëtarizimit. Një gjë e tillë realizohet nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL-të jashtë vendit (*Evidencë R.2.c*) realizimit të konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore të përbashkëta (*Evidencë R.2.d*) dhe së fundmi nëpërmjet mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve. (*Evidencë R.2.e*)
- Me rëndësi për ofrimin me cilësi të programeve të studimit është dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale të studentëve (*Evidencë R.2.f*) si dhe,
- Nënshkrimi i një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL-et kombëtare dhe institucionet publike e jopublike për realizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter kërkimor-shkencor në ndihmë të procesit mësimor dhe studentëve si dhe shkëmbimit të stafit me to në përputhje me legjislacionin në fuqi. (*Evidencë R.2.g*)
- Së fundmi, theksojmë se të gjitha programet e ofruara në AU i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm periodik brenda afatave të përcaktuara dhe kanë kaluar me sukses akreditimin nga Bordi i Akreditimit të ASCAL.

3. Institucioni duhet të hartojë një strategji të posaçme për zhvillimin dhe zbatimin e kërkimit shkencor dhe të hartojë një plan veprimi për implementimin e saj

Institucioni ka ngritur grupin e punës me Vendim Rektorati (*Evidencë R.3.a*) i cili ka punuar për rishikimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor në AU (*Evidencë R.3.b*) si dhe ka hartuar planin e masave për realizimin e saj.

4. Institucioni duhet të zbatojë përmes veprimeve konkrete, fushat që përbëjnë prioritetet për kërkimin shkencor.

Në përputhje me vendimin e Rektoratit të AU (*Evidencë R.4.a*) në fillim të vitit akademik, Njësitë Bazë përcaktojnë një tematikë kryesore e cila është në fokus të veprimtarisë kërkimore- shkencore të Departamentit, në përputhje edhe me zhvillimet social-ekonomike të vendit. (*Evidencë R.4.b*). Bashkëngjitur gjeni një procedurë të përcaktimit të temës dhe të aktiviteteve të realizuara nga Njësia Bazë në përputhje me të. (*Evidencë R.4.c*).

Albanian University e konsideron si një angazhim të vazhdueshëm këtë plan veprimi, jo vetëm për përmbushjen e rekomandimeve për akreditimin institucional, por edhe për arritjen dhe ruajtjen e standardeve që i vlejné qëndrueshmërisë dhe rritjes së performancës së stafit akademik në kohë.

3. Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

1 – FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

Autonomia
<p>Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit. <i>(Kreu III Standardi I.1)</i></p> <p>Albanian University e ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e tij në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me të ka rishikuar të gjitha aktet normative të tij. Kështu, Albanian University ka miratuar Statutin e tij (<i>Evidencë Nr.1.1</i>) me Vendim Senati Akademik (<i>Evidencë Nr.1.2</i>) dhe me Urdhër Nr. 596 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dt.21.12.2016 (<i>Evidencë Nr.1.3</i>), Rregulloren e Përgjithshme (<i>Evidencë Nr.1.4</i>), si dhe në përputhje me to të gjitha aktet e tjera normative të Institucionit si: Rregulloret e Njësive Kryesore, Rregulloret e Njësive Bazë, Rregulloret e Programeve të Studimit si dhe çdo Rregullore tjetër e cila parashikohet shprehimisht ne Statut.</p> <p>Në AU të gjitha aktet normative janë objekt i rishikimit të vazhdueshëm. Konkretisht, në Maj të vitit 2017 Albanian University ka rishikuar Rregulloren e Përgjithshme dhe ndryshimet e realizuara në të janë miratuar me Vendim Senati Akademik. (<i>Evidencë Nr.1.5</i>)</p>
<p>Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efijencë në menaxhim. <i>(Kreu III Standardi I.2)</i></p> <p>Në AU, Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të Administratorëve të njësive kryesore dhe ia paraqet për miratim Senatit;</p> <p>Administratori i Përgjithshëm, njëherazi anëtar i Rektoratit, mbështetur në propozimet e njësive bazë, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm 3-vjeçar të AU. Senati i propozon për miratim Bordit të Administrimit, projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm 3-vjeçar të AU, hartuar nga Administratori i Përgjithshëm.</p> <p>Bordi i administrimit vendos rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ja përcjell organeve drejtuese akademike.</p> <p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.</p> <p>Organizimi i brendshëm në AU bëhet në përputhje me përcaktimet në Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme. Më shumë informacion për mënyrën e funksionimit të organeve të mësipërme kolegjiale gjeni në statut dhe rregullore, në të cilat specifikohen kompetencat, detyrat dhe funksionet e secilit prej tyre, me qëllim organizimin që të sigurohet efijencë në menaxhim.</p>

Institucioni favorizon debatin konstruktiv. (*Kreu III Standard I.3*)

Në AU, vendimmarrja në organet kolegiale bëhet sipas një procedure të caktuar, duke respektuar të drejtën e kujtdo, i cili/e cila është anëtar i këtyre strukturave.

Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv dhe kryesohet nga Rektori. Mbledhjet e Rektoratit realizohen 1 herë në muaj dhe zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve. Rektorati i aprovon vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm (***Evidencë Nr. 1.6, neni 3&4***)

Senati Akademik është organi kolegjal vendimmarrës më i lartë në nivel Universiteti. Mbledhjet e Senatit Akademik thirren me një rend dite të përcaktuar, propozuar nga Kryetari. Njoftimi për mbledhjen e Senatit u dërgohet anëtarëve, me shkresë ose email. Njoftimin e organizon Rektorati (***Evidencë 1.7, Neni 16***) Mbledhjet e Senatit, në zbatim të Nenit 20, pika 1 të Statutit të AU zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave, me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon ndryshe. (***Evidencë 1.7, Neni 14***) Senati Akademik, sipas rregullimeve të parashikuara shprehimisht në Statut dhe në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, mbledhet periodikisht në sesione të rregullta, 3 (tre) herë në një semestër. (***Evidencë Nr.1.1, Neni 20***) Vendimet e Senatit nënshkruhen nga Kryetari i tij dhe përcillen brenda 5 ditëve nga përfundimi i mbledhjes përkatëse. Vendimet përcillen në njësitë përkatëse për zbatim. (***Evidencë 1.7, Neni 20***)

Bordi i administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ. Mbledhjet në këtë organ thirren nga Kryetari. Anëtarët e Bordit të Administrimit marrin pjesë në diskutime dhe paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet të cilat trajtohen në mbledhje. Mbledhjet e Bordit të Administrimit zhvillohen të mbyllura. Kryetari e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim, rregulla këto të parashikuara shprehimisht në Rregulloren “Mbi organizimin dhe funksionin e Bordit të Administrimit”, përkatësisht nenin 10 të kësaj Rregulloreje. (***Evidencë Nr.1.8, Neni 10***) Bordi mbledhet rregullisht 3 (tre) herë në një tremestër, dhe mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme. (***Po aty, Neni 8***)

Diskutimet e zhvilluara në mbledhjet e Bordit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga mbajtësi i tij, dhe Kryetari (***Po aty, Neni 14***)

Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij. (*Kreu III Standardi I.4*)

AU i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe formimit të kulturës së cilësisë në institucion. (***Evidencë Nr. 1.9***) Për këtë qëllim në AU është ngritur struktura e cilësisë, që përbëhet nga Komisioni për Vlerësim Institucional dhe nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Komisioni për Vlerësim Institucional është ngritur me Vendim Senati Akademik në vitin 2017 (***Evidencë Nr.1.10***) në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është përgjegjës për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur që në vitin 2010 me Vendim të Senatit Akademik Nr.178 datë 23.07.2010 (***Evidencë Nr. 1.11***) konform udhëzimeve të APAAL dhe Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe është përgjegjëse për të gjitha çështjet e

lidhura me cilësinë e brendshme të cilat kanë si qëllim përmirësimin dhe ruajtjen në nivel të lartë të shërbimeve akademike dhe administrative të AU.

Sigurimi i cilësisë në AU inicion në nivel Njësie Bazë me gritjen e grupeve *ad hoc* të cilët merren me çështje të tilla si rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programeve të ndryshme të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor e kërkimor shkencor. (*Evidencë nr. 1.12a,b*)

AU bazuar në nevojat e tij si dhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase ndër vite ka angazhuar këshilltarë të jashtëm. Aktualisht, pranë AU janë angazhuar 1 konsulent juridik, një konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe një konsulent për marrëdhëniet me jashtë. (*Evidencë Nr. 1.13.a,b,c*) Gjithashtu, AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me zyrën e avokatisë “Celibashi & associates” për konsulencë të ndryshme juridike në varësi të nevojave të Institucionit. (*Evidencë Nr. 1.13.d*)

AU është organizuar në mënyrë të tillë që të përfitojë financime nga programet europiane dhe me gjerë. Për këtë qëllim, në institucion angazhohet Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike në bashkëpunim me strukturat e tjera. Konkretisht, Njësitë Bazë informohen dhe motivohen për të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare, si dhe mbështeten në pjesëmarrjen konkrete në projekte.

Gjatë 2 viteve të fundit, AU ka fituar disa projekte të listuara më poshtë dhe është në proces të zbatimit të tyre:

1. Projekti GRADUA (*Evidencë Nr. 1.14*)
2. Projekti HYPOSENSE (*Evidencë Nr. 1.15*)
3. Projekti me Arkivat e Shtetit (*Evidencë Nr. 1.16*)
4. Projekti me Kuvendin e Shqipërisë (*Evidencë Nr. 1.17*)

Së fundmi, AU ka aplikuar në një sërë projektesh të tjera të cilat janë në proces vlerësimi. (*Evidencë Nr. 1.18*).

Institucioni harton një strategji zhvillimi. (*Kreu III Standardi I.5*)

AU harton dhe adopton në vazhdimësi strategji zhvillimi. Zhvillimi strategjik i AU është bazuar në planin strategjik për periudhën 2017-2022 (*Evidencë Nr. 1.19*), e cila pasi është diskutuar në organet kolegjiale përkatëse është miratuar në Senatën Akademik me Vendim Nr.14, dt. 28.12.2016 (*Evidencë Nr.1.20*). Strategjia është e ndërtuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Në planin Strategjik të institucionit përcaktohen, cilësia e lartë në menaxhim, kërkim dhe zhvillim, me qëllim krijimin e një komuniteti kombëtar, rajonal e më gjerë, i cili bazohet në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky zhvillim në bazë të strategjisë mund të realizohet më së miri në sajë të një bashkëpunimi të vazhdueshëm i cili konsiston në këmbimin e eksperiencave në të gjitha format e veta midis Institucioneve të Arsimit të Lartë Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Në kuadër të implementimit të strategjisë, AU realizon edhe planin e masave me qëllimin monitorimin e zbatimit cilësor të saj. (*Evidencë Nr. 1.21*)

Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe para personelit akademik e studentëve. (*Kreu III Standardi I.6*)

Albanian University në përfundim të çdo viti akademik harton raportin vjetor (*Evidencë Nr. 1.22*), në përputhje me Udhëzimin Nr.5 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dt.19.02.2018 për “Përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë” (*Evidencë Nr.1.23*), e miraton në një mbledhje të përbashkët midis Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit (*Evidencë Nr. 1.24*) e bën publik në faqen zyrtare të tij (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/>) dhe e dërgon në MASR (*Evidencë Nr.1.25*).

Raporti paraqet interes jo vetëm për MASR, e cila verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore, por njëkohësisht edhe për të gjithë studentët e ardhshëm, duke i ofruar një panoramë të qartë që i vjen në ndihmë atyre në zgjedhjet për të ardhmen e jetës universitare e më gjerë.

Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (*Kreu III Standardi II.1*)

AU në përputhje me Ligjin në fuqi si dhe në respektim të Statutit, në kuadër të përmbushjes së qëllimit dhe misionit të tij është institucion autonom dhe gëzon liri akademike në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në krijim. (*Evidencë Nr. 1.1, neni 4 & 5 fq.2-3*)

AU ka statusin Universitet. AU përbëhet nga tre fakultete, të cilat janë të formuara me nga 3- 4 departamente: (*Evidencë Nr. 1.26*)

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore:
 - Departamenti i Stomatologjisë,
 - Departamenti i Farmacisë,
 - Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
 - Departamenti i Shkencave Ekonomike,
 - Departamenti i Arkitekturës dhe
 - Departamenti i Inxhinierive;
3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
 - Departamenti i Shkencave Juridike,
 - Departamenti i Shkencave Politike Administrative,
 - Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe
 - Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Çdo njësi kyesore, dhe njësi bazë organizohet dhe funksionon në bazë të kërkesavë të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit, Rregullores së Përgjithshme, si dhe Rregulloreve të funksionimit të tyre.

AU ofron programe studimi në të tre Ciklet e studimit Bachelor, Master, si dhe programe të ciklit të tretë Specializime dhe Doktoraturë. (*Evidencë Nr. 1.27*)

Çdo departament ka në përbërje të tij së paku 7 anëtarë efektivë dhe të paktën 3 prej tyre janë me grada dhe tituj (*Evidencë Nr. 1.28*)

Gjithashtu, në përmbushje të plotë të kriterëve ligjore për të realizuar në mënyrë të suksesshme misionin dhe qëllimin për të cilin është ngritur, Institucioni ka një faqe web të strukturuar mirë, i cili siguron të gjithë informacionin përkatës për cilindo që është interesuar të bëhet pjesë e tij. (www.albanianuniversity.edu.al)

Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit. (Kreu III Standardi II.3)

Në AU, çdo punonjësi të institucionit i jepet e drejta që të shprehë lirisht mendimin e tij në funksion të gjetjes së zgjidhjes optimale për çështjet objekt-shqyrtimi.

Duke filluar që në nivel Njësie Bazë, në mbledhjet periodike të zhvilluara çdo anëtar i personelit akademik, pjesë e departamentit, ka të drejtë të shprehë lirshëm mendimin e tij për çështje të rëndësishme diskutimi në favor të marrjes së vendimeve.

Gjithashtu, në Asamblenë e Personelit Akademik çdo personel akademik me kohë të plotë i Njesisë Kryesore shpreh mendimin e tij të lirë për çështje të ndryshme objekt diskutimi.

Po ashtu, përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik dhe në Komisionet Institucionale është një element shumë pozitiv, pasi kjo i jep atyre mundësinë që të shprehin direkt mendimet/shqetësimet në organet më të lartë vendimmarrëse në realizimin e misionit të institucionit, që në thelb ka vetë studentët. **(Evidencë Nr. 1.29)**

Partneriteti

Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. (Kreu III Standardi III.1)

Në AU për çdo program studimi të ofruar realizohet analiza e tregut të punës. **(Evidencë Nr. 1.30)**

Ky studim realizohet nga grupet ad-hoc të ngritur në nivel Njësie Bazë dhe synon të evidentojë efikasitetin e programit të studimit në tregun e punës dhe informimin e institucionit në mënyrë të vazhdueshme për trendin e zhvillimit në fushën përkatëse dhe atë ekonomik rajonal. Pjesë e grupit të ngritur në nivel njësie bazë për realizimin e studimit të tregut të punës janë edhe përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi. **(Evidencë Nr. 1.31)**

Nëpërmjet këtij studimi, institucioni ka arritur të krijojë një vizion pavarësisht se shpeshherë është hasur vështirësi në mbledhjen e plotë të të dhënave për shkak të mungesës së një studimi tregu të mirëfilltë të realizuar në nivel kombëtar.

AU bazuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe kërkesat e tregut të punës, gjatë vitit akademik 2018-2019 ka hapur programe të reja studimi Master Profesional në:

- a. Interier Dizajn
- b. Sisteme të Energjisë
- c. Terapi Manuale **(Evidencë Nr. 1.32)**

Si dhe ka aplikuar për hapjen e 9 programeve të studimit të ciklit të parë bachelor, ciklit të dytë master profesional e master i shkencave dhe doktoratë pranë MASR dhe është në pritje të miratimit të tyre nga Ministria përgjegjëse për Arsimin për ti bërë aktive në vitin akademik 2019-2020. **(Evidencë Nr. 1.33)**

AU nëpërmjet zyrës së Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët Alumni të tij dhe disponon të dhënat e punësimit të tyre. **(Evidencë Nr. 1.34)**

Vlen të theksohet fakti që në kuadër të nismës së ndërmarrë nga Këshilli i Ministrave për punësimin e studentëve të ekselencës në administratën shtetërore, 3 studentë të AU kanë përfituar nga kjo nismë duke u pozicionuar në një vend pune në përputhje me profilin e tyre të diplomimit.

AU, në tregun e Arsimit të Lartë respekton rregullat e konkurrencës, duke pasur një qëndrim të qartë në tregun e IAL-ve private në vite, duke publikuar për çdo vit akademik, tarifën e studimit për çdo program studimi <https://albanianuniversity.edu.al/sq/broshura/>. (*Evidencë Nr. 1.35*)

Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. (*Kreu III Standardi III.2*)

AU ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Një gjë e tillë është e shprehur edhe në strategjinë institucionale, por njëkohësisht AU ka hartuar edhe Strategjinë “Për Partneritetin dhe Komunikimin”, në të cilën janë të përcaktuara prioritetet e politikës së bashkëpunimit. (*Evidencë Nr. 1.36*). Në këtë kuadër AU ka vendosur partneritete me institucione arsimore që të punojnë së bashku për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme në drejtimin e studimeve shkencore duke promovuar iniciativat shkencore dhe të shkëmbimit kulturor. Nisur nga kjo AU ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare. (*Evidencë Nr. 1.37*)

Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet të tjera mbështetëse. (*Kreu III Standardi III.3*)

AU bashkëpunon me organizata të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve, në kuadrin e praktikave profesionale. (*Evidencë R.2.f*)

AU, për plotësimin e nevojave të veta në funksion të realizimit sa më cilësor të programeve të studimeve ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe institucione të tjera publike e private, biznese, etj.

Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar. (*Kreu III Standardi III.4*)

AU dhe personeli i tij akademik merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare, prezanton kumtesa në konferenca, kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizon vetë aktivitete ndërkombëtare, si p.sh. konferenca shkencore, simpoziume, etj.

AU bazuar në politikën e zhvillimit Institucional dhe në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë procesit të mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. Nisur nga kjo gjatë vitit akademik 2017-2018, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të cilat AU ka nënshkruar me institucione të ndryshme dhe marrëveshjeve Erasmus +, kanë përfituar mobilitet 8 anëtarë të personelit akademik dhe 4 studentë. (*Evidence Nr. R.1.e & R.2.e*)

Ndërkohë, gjatë këtij viti kanë përfituar mobilitet 5 anëtarë të personelit akademik dhe 3 studentë. (*Evidence Nr. R.1.e & R.2.e*)

AU mbi bazën e kuotave të përcaktuara nga MASR, i jep të drejtën e studimit, studentëve jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, pranë AU ndjekin studimet 29 studentë të huaj. (*Evidencë Nr. 1.38*)

Gjithashtu, AU ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të institucionit ashtu edhe të tyre.

AU mirëpret në kuadër të marrëveshjeve institucionale profesore të huaj për realizimin e procesit

mësimor, kryesisht për programet e ciklit të 3-të të studimeve. (*Evidencë Nr. 1.39*)

Përfundimi dhe Vlerësimi

GVB arrin në përfundimin se AU në bazë të statutit të tij, ka ngritur struktura që implementojnë plotësisht misionin dhe qëllimet për të cilat është ngritur. Të gjitha strukturat e ngritura i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me rregulloret përkatëse që janë miratuar në zbatim të Statutit të AU dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku përveç detyrave individuale që ato realizojnë rezultojnë edhe bashkëpunimi midis tyre është plotësisht në përmbushje të misionit të AU.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është një pikë kyçe në Institucion e cila në përputhje me aktet ligjorë në fuqi, standardet shtetërore të cilësisë si dhe manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit” të ASCAL ushtron funksionin e saj duke siguruar të dhëna objektive dhe duke kontribuar në ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Institucion.

Gjithashtu, GVB konkludon se Institucioni në përmbushje të misionit dhe qëllimeve të tij e shikon partneritetin kombëtar dhe ndërkombëtar si element themelor, për përfundimin e projekteve të ndryshme, nxitjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të parametrevë të cilësisë.

2 – FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Institucioni ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore. (*Kreu III Standarti IV.1*)

Albanian University (AU) ka strukturën e vet Institucionale, organigramën (*Evidencë Nr.1.26*) të cilën e ka të publikuar në faqen e internetit. (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/>).

Rekrutimi i stafit akademik në AU bazohet në respektim të kërkesave të kuadrit ligjor për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës si dhe në Statutin e AU. (*Evidencë Nr. 1.1, neni 43, fq. 20*)

Çdo vit akademik, AU në funksion të nevojave për personel akademik që propozon çdo njësi bazë e tij, organizon procedura konkurrimi si për personel me kohë të plotë ashtu edhe për pedagogë me kohë të pjesshme, e rregulluar kjo procedurë shprehimisht në Rregulloren e Përgjithshme të AU. (*Evidencë Nr. 1.4, neni 27, fq. 22*)

Zyra e Burimeve Njerëzore në AU, publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/vend-vakant-personel-akademik-me-kohë-te-plote/>) si dhe në mjetet e tjera të informimit publik. (*Evidencë Nr. 1.1, neni 43, fq. 20*) (*Evidencë Nr. 1.4, neni 27, fq. 22*); (*Evidencë Nr. 2.1-a,b,c*)

Është në Strategjinë e AU, si një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së saj promovimi i personelit akademik (*Evidencë Nr. 1.19, objektivi 6, fq.25*) Promovimi i personelit akademik, por edhe atij ndihmës mësimor dhe administrativ, është një nga objektivat kryesorë të AU. Këtë

e dëshmon edhe fakti, që pjesë të këtij personeli të të punësuarve në AU, jo vetëm janë arsimuar pranë AU (*Evidencë Nr.2.2*), veçanërisht në programet e studimeve Master, por disa prej tyre janë edhe në proces të studimeve të Doktoratës, në programet që AU ofron.

Në punësimin e personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ, AU zbaton kriteret ligjore në funksion të kërkesave të legjislacionit në fuqi për Arsimin e Lartë, si ligji Nr.80/2015 apo aktet nënligjorë për zbatim të tij.

Punësimi i personelit në AU, respekton edhe kërkesat e Kodit të Punës ku çdo i punësuar rregullon marrëdhëniet e tij me një kontratë pune individuale. (*Evidencë Nr.2.3 & R.1.c*)

Në përputhje me Legjislacionin në fuqi si dhe Kodin e Punës, është hartuar edhe Statuti i AU-së, i cili rregullon posaçërisht këto dy kategori: personelin ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe personelin ndihmës-akademik me karakter administrativ(*Evidencë nr. 1.1, neni 39, pika b,c, fq. 19*).

AU, bazuar edhe mbi statistikat përkatëse dëshmon se ka prioritet rekrutimin e një stafi akademik të kualifikuar dhe të diplomuar jashtë vendit me gradë shkencore dhe tituj akademikë. (*Evidencë Nr.2.4*)

Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. (*Kreu III Standardi IV.2*)

AU është angazhuar vazhdimisht me politikat integruese të stafit akademik duke i dhënë atyre mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies. (*Evidencë Nr.2.5 & R.2.a*) Të njëjtën politikë AU ndjek edhe për personelin ndihmës akademik, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në trajnime të ndryshme, si të organizuara nga vetë struktura e AU, ashtu edhe jashtë AU. (*Evidencë Nr. 2.6-a,b*).

Në ditët e informimit (Open Days), të cilat janë të lidhura ngushtë me fillimin e vitit të ri akademik, i gjithë stafi, si akademik, ashtu dhe ai ndihmës-akademik është i përfshirë në procesin e informimit, për të dhënë një informacion sa më të gjerë për programet e studimit që AU ofron, stafin akademik dhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm për kandidatët për student, të publikuara edhe në rrjetet sociale: <https://www.facebook.com/events/819602458438311/>. Këto Ditë Informimi realizohen përmes broshurave informuese dhe prezantimeve nga përgjegjësit e departamenteve dhe anëtarët e stafit/personelit akademik. (*Evidencë Nr. 2.7-a,b,c,d,ef,g,h*).

Si një Institucion i konsoliduar, AU integron stafin në jetën e tij sociale, e cila pasqyrohet qartë në eventet e ndryshme që ai zhvillon, të tilla si: promovimi i librave; organizimi i tryezave të debatit me aktorë të ndryshëm të biznesit, për çështje të ditës; pjesëmarrja e personaliteteve të ndryshme nga fusha të caktuara të shkencës, politikës apo artit në ambientet e AU apo jashtë tij. https://youtu.be/TtEUNY_g6eo (*Evidencë Nr. 2.8-a,b*)

Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij. (*Kreu III Standardi IV.3*)

Strategjia e zhvillimit të AU, ka si një ndër prioritetet kryesore kualifikimin e mëtjshëm të stafit të saj akademik. AU, ka nxitur vazhdimisht kualifikimin e stafit akademik, e fokusuar kjo në këto drejtime:

1. Organizimi i konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me universitete të njohura në Europë ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në përmbledhjen e abstrakteve apo “Proceedings” me numër ISBN-je. *(Evidencë Nr. 2.9-a,b,c,d,e)* Gjithashtu, konferencat e organizuara në fushën e mjekësisë janë akredituar për profesionistët nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV);
2. Promovimi i anëtarëve të stafit akademik, nëpërmjet mbështetjes financiare në aktivitete të ndryshme shkencore – konferenca; simpoziume; kongrese të organizuara në AU apo jashtë vendit *(Evidencë Nr. 2.10-a,b)*;
3. Publikimi i Revistes shkencore OPTIME 2 herë në vit *(Evidencë Nr. 2.11)*, ku anëtarët e stafit akademik, kanë mundësi që në funksion të rritjes së nivelit të tyre akademik, të publikojnë në këtë revistë pasi kalojnë në një proces recensimi për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore;
4. Mbështetja financiare nga ana e AU, për botimin e teksteve të ndryshme mësimore, në formën e librave apo leksioneve të shkruara përmes shtëpisë botuese AU Press; *(Evidencë Nr.2.12)*
5. Promovimi i anëtarëve të stafit akademik, nëpërmjet një sistemi të diferencuar në pagë, në funksion të titujve dhe gradave shkencore që ata kanë, si dhe bazuar në kontributin që ata japin në Institucion.

Personelit Akademik të kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” në AU i takon e drejta e vitit sabatik një herë në shtatë vjet për një periudhë kohe deri në një vit.

AU, nëpërmjet njësive bazë të saj – Departamenteve realizon në fund të çdo viti akademik një vlerësim për punën dhe performancën e çdo anëtari të stafit/personelit akademik. *(Evidencë Nr. 2.13)*

AU mbështet kualifikimin e stafit/personelit duke ofruar programe studimi të Ciklit të tretë, doktoratë në AU. Këto programe studimi mbështeten në marrëveshje bashkëpunimi me Universitetet jashtë vendit, me angazhimin e stafit/personelit akademik të tyre në programet e Ciklit të tretë apo si mbështetës të rëndësishëm të projekteve kërkimore shkencore. *(Evidencë Nr. 2.14-a,b,c)*

AU mbështet mobilitetin e personelit akademik me qëllim kualifikimin e tij bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL-të në Europë, programit Erasmus +, si dhe në shkëmbimin e përvojës nëpërmjet pjesëmarrjes së pedagogëve të huaj, si lektorë pranë AU, në leksione të hapura, work-shope, konferenca shkencore me qëllim rritjen e kapaciteteve akademike dhe nivelin e ekspertizës së AU *(Evidencë Nr. 1.39 & R.1.e)*.

Më qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e cilësisë, në përbërje të strukturave kolegjiale, siç është Bordi Drejtues i Revistës OPTIME me ISSN, ka edhe profesorë të huaj. *(Evidencë Nr. 2.15)*

Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social. *(Kreu III Standardi IV.4)*

AU ka organizuar disa aktivitete sociale me pjesëmarrjen vullnetare të studentëve në bashkëpunim dhe me partnerë të tjerë si p.sh. Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Klinikën Universitare

në ndihmë të fëmijëve jetim apo grave të dhunuara, duke inkurajuar edhe dialogun social në mbrojtje të këtyre kategorive sociale (*Evidencë Nr. 2.16-a,b*).

AU e shikon të lidhur ngushtë favorizimin e dialogut social, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe atë ndërkombëtar. Kështu, marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitete të huaja, AU i vlerëson si një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjellë të kulturave, për zhvillimin shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre. (*Evidencë Nr. R.2.c*)

Në funksion të zhvillimit të një politike sociale AU e trajton marrëdhënien e punës së çdo anëtari të stafit/personelit të saj, si një të drejtë sociale, nga e cila burojnë të drejtat e tjera – ato për sigurimin e jetës dhe të shëndetit.

Kështu, çdo kontratë pune është e deklaruar pranë organeve shtetërore përkatëse, dhe çdo person i punësuar në AU, përfiton në bazë të ligjit Nr.7703/1993 , ndryshuar “Për sigurimet shoqërore në R.SH” të drejtat që rrjedhin nga ky ligj, parashikuar shprehimisht në kontratën individuale të punës. (*Evidencë Nr. R.1.c*)

Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore. (Kreu III Standardi II.2)

AU siguron menaxhimin efikas të Burimeve Njerëzore.

Zyra e Burimeve Njerëzore është një strukturë administrative shumë e rëndësishme koordinuese brenda Universitetit ku depozitohet nga punëmarrësit i gjithë dokumentacioni i nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e AU. (*Evidencë Nr.2.17*)

Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek përmbushjen e detyrimeve kontraktore të punëmarrësve në përputhje edhe me kodin e Etikës. Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe harton raporte statistikore për personelin sipas kërkesave të Institucionit.

Menaxhimi Financiar

Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara. (Kreu III Standardi VI.1)

Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në AU bëhet në bazë të një Programi financiar afatmesëm 3-vjeçar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr.80/2015 Për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në Ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Struktura e programit financiar është bërë duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve në të cilin ato do të përdoren. (*Evidencë Nr. 2.18*)

AU si pjesë e Shoqërisë UFO shpk, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat bazuar në programin financiar (program financiar afatmesëm 3-vjeçar).

Programi financiar miratohet nga Bordi i Administrimit pasi hartohet nga Rektorati si dhe pasi është bërë objekt diskutimi në Senat Akademik. (*Evidencë nr. 1.1, neni 22, pika 5*)

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare. (Kreu III Standardi VI.2)

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për zbatimin e politikave financiare, të parashikuara në programin financiar. Për këtë qëllim në strukturën organizative të AU është ngritur dhe funksionon një strukturë e posaçme, që krahas detyrave të tjera ushtron edhe atë për hartimin dhe zbatimin e Programit Financiar. Kjo strukturë fillon nga Njësia Bazë dhe drejtohet nga Bordi i Administrimit të AU-së. (*Evidencë Nr. 2.19*)

Burimet financiare të institucionit janë hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të AU, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. Procesi i hartimit të programi financiar fillon në muajin Shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit Dhjetor të vitit paraardhës financiar.

Situata financiare e këtij Institucioni është e qëndrueshme nga fillimi i tij dhe premtion një të ardhme të kënaqshme e të qëndrueshme.

Si gjatë hartimit të Programit financiar edhe gjatë zbatimit të tij në AU zbatohen rregullat e Ligjit për kontabilitetin, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në zbatim të tij dhe të gjitha rregullave të tjera financiare-fiskale, sipas ligjeve dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore në fuqi.

Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar. (*Kreu III Standardi VI.3*)

Veprimtaria financiare e AU është objekt i Auditorëve Ligjorë të Pasqyrave Financiare, në përputhje me Ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të Auditimit të raportimit Financiar. Që me miratimin e Statutit të ristrukturuar sipas Ligjit 80/15 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë, në AU funksionon edhe zyra e Auditit të brendshëm.

Pasqyrat Financiare të Institucionit bëhen publike çdo vit, së bashku me raportin e Auditit Ligjor, në përputhje me ligjin për Kontabilitetin dhe Ligjit për QKB.

Pas analizave dhe diskutimeve në strukturat përkatëse të AU, raporti i veprimtarisë financiare pasi hartohet nga rektorati diskutohet në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit (*Evidencë Nr. 1.4, neni 5, pika 6*).

Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit

Institucioni disponon një sistem të informimit. (*Kreu III Standardi VII.1*)

AU ka sisteme informacioni të koordinuara mirë. Strukturat përgjegjëse të ngarkuara me administrimin e sistemit të informacionit janë: Zyra e Informacionit, Zyra e IT dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë (*Evidencë Nr. 1.26*).

Të gjitha zyrat e AU janë përgjegjëse për të dhënë informacion të detajuar për institucionin, duke ruajtur konfidencialitetin për çështje specifike. Midis vetë strukturave të universitetit përdoret edhe intraneti.

Qëllimi i sistemit të informacionit është mbështetja, koordinimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe punës së stafit/personelit akademik, stafit/personelit ndihmës-akademik, dhe studentëve nëpërmjet gamës së faciliteteve të mbështetura në internet si: laboratorët, arkiva elektronike, sekretaria online, webmail etj.

Sistemi i informimit online ose sekretaria online është një program i cili i jep mundësinë studentëve të logohen në kohe reale, nëpërmjet internetit, kudo që ata ndodhen. Secili prej studenteve ka llogarinë e tij, ku mund të logohet me kredencialet e tij dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojë. Linku për tu loguar është: <http://on.albanianuniversity.edu.al/login>

Për sa i përket komunikimit dhe disponimit elektronik, AU ka faqen e vet zyrtare (<http://albanianuniversity.edu.al>) e cila është e mirë organizuar dhe ofron informacione të nevojshme si për publikun e gjerë, ashtu dhe për studentët e pedagogët/personelin akademik si: kalendarin akademik vjetor, oraret mësimore, oraret e sezoneve të provimeve, aktivitetet, takimet dhe mbledhjet e punës, eventet sociale, raportet e vetëvlerësimit, oferta akademike, statutin, strukturën organizative, rregulloren e funksionimit të faqes web etj. (*Evidencë Nr. 2.20*).

Për të promovuar aktivitetin akademik dhe social, AU shërbehet edhe nga televizioni UTV News (pronë e të njëjtit grup biznesi).

Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit. (*Kreu III Standardi VII.2*)

AU është plotësisht i informatizuar me instalimet e IT në të gjitha godinat e tij. Institucioni disponon dhe vë në funksion të punës së pavarur të pedagogëve dhe studentëve me orar të zgjatur salla pune dhe laboratorë informatike. Studentët mbështeten për studimet e tyre në internet jo vetëm nga punonjëset e bibliotekës, por edhe nga vetë pedagogët e tyre.

Sallat mësimore janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit; në dispozicion janë 4 laboratorë informatike.

Biblioteka është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë online. Mjediset e AU mbulohen me sinjal Wi-fi.

Laboratorët janë të pajisur me software-t përkatës.

Videokasetat dhe CD janë pjesë e zhvillimit të orëve të ndryshme mësimore; pedagogët/personeli akademik përdorin filma dhe dokumentarë si pikënisje të debeteve dhe diskutimeve për një temë mësimore.

Institucioni nuk ofron programe të studimit në distancë.

Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme. (*Kreu III Standardi VII.3*)

Institucioni ka një evidencë të pasurive të paluajtshme të tij, bazuar këto në kontrata përdorimi - qiraje. (*Evidencë Nr. 2.21- a,b,c,d,e,f*)

AU në funksion të procesit mësimor për vitin akademik 2018-2019, ka në administrim 6 (gjashtë) godina:

Godina 1 (Bulevardi Zogu I, ish- Estrada) me 4 kate, me sipërfaqe totale 3.996 m².

Godina 2 (Rruga e Durrësit, ish Gjykata) me 4 kate, me sipërfaqe totale 2.267m².

Godina 3 (Rruga K. Karafili - Internacionali) me 5 kate, me sipërfaqe totale 1.835m².

Godina 4 (Rruga e Kavajës – FSHA) me 6 kate, me sipërfaqe totale 1.902 m². (*Evidencë nr. 2.22-a,b,c,d,e*)

Albanian University, si pjesë e Shoqërisë tregtare UFO shpk, ka një masterplan për sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin, dhe/ose ristrukturimin e pasurive të paluajtshme të tij; më konkretisht, në territorin e selisë qendrore të universitetit, pritet të miratohet ndërtimi i një strukturë e re moderne që do i shërbejë universitetit, në kuadër të planit urbanistik të bashkisë Tiranë.

AU menaxhon asetet e tij sipas një plani të përcaktuar, që synon përmirësimin e cilësisë së ambienteve mësimore dhe shkencore, të pasqyruar edhe në buxhetin e përvitshëm të institucionit të paraqitur pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë;

AU ka të punësuar arkitektë me kohë të plotë të cilët merren me projektimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të tij të ndërtimit, rindërtimit dhe rikonstruksioneve pjesore si dhe kontraktin specialistë të jashtëm të licencuar sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. (*Kreu III Standardi VII.4*)

AU si një nga institucionet e para private në Arsimin e Lartë në Shqipëri, tashmë ka krijuar edhe trashëgiminë e tij, akademike, kulturore dhe shkencore, trashëgimi e cila përcakton edhe fizionominë e tij si një IAL i konsoliduar dhe bashkëkohor.

AU punon vazhdimisht për ruajtjen, regjistrimin, arkivimin, klasifikimin e fondit dokumentar dhe arkivor të trashëgimisë së vet akademike, kulturore dhe shkencore.

Kështu, pranë AU është ngritur Zyra e Arshivës dhe Protokollit, që administrohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 9154/2003, ndryshuar “Për arkivat”, si dhe Rregullores Protokoll-Arkiv. (*Evidencë Nr. 2.23*)

Ruajtja dhe regjistrimi i trashëgimisë së AU realizohet jo vetëm prej arkivit të institucionit, por edhe televizionit që Institucioni zotëron.

Kështu, Institucioni ka organizuar evente si: promovim të librave të personaliteteve akademike, pjesëmarrjen në panaire të librit, organizimin e ekspozitave të ndryshme, organizim të ceremonive nderuese për figurat akademike të tij si dhe aktivite të tjera në funksion të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë që ai ofron. AU ndjek një politikë të vlerësimit dhe zhvillimit të pasurive të tij akademike, kulturore dhe shkencore, përmes dhënies së titujve “Honoris Causa” nga Senati Akademik i AU. (*Evidencë Nr. 2.24*)

AU ka një shtëpi botuese “Albanian University Press”.

E gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit është e arkivuar edhe në rrugë elektronike si një pasuri që trashëgohet në vite dhe që u shërben brezave në vazhdim.

Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij. (*Kreu III Standardi VII.5*)

Infrastruktura e universitetit ofron kushte të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e veprimtarisë së përditshme akademike dhe administrative si: ambiente për personelin akademik, ambiente për personelin administrativ, sekretarinë mësimore, salla leksionesh, seminaresh, ambiente për laboratorë, Senatin, salla audiovizive, salla kompjuterësh, salla për konferenca, ambiente për bibliotekën, mjedise shërbimi për të tretë, mjedise sportive etj.

AU disponon mjedise në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik, në përpjesëtim me

numrin e tij, në mënyrë që secili nga anëtarët e stafit të ketë vendin e tij të punës në një zyrë apo mjedise të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin shkencor dhe mësimor.

Institucioni ngre një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët (*Kreu III Standardi VII.6*)

Struktura logjistike administrative e Institucionit i shërben vetë kërkesave të Institucionit për mbarëvajtjen e punës, si edhe për të ofruar shërbime për të tretët, në përputhje me nevojat e tregut.

AU nëpërmjet Klinikës Universitare Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”, Klinikës së Fizioterapisë, me mbështetjen e personelit vendas dhe të huaj ofron shërbime mjekësore për të tretët. Shtëpia botuese “Albanian University Press” mbështet gjithë veprimtarinë botuese jo vetëm në funksion të stafit/personelit dhe studentëve të AU, por për gjithë grupet e interesit në gjithë vendin. Gjithashtu, AU bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me UTV News ofron shërbime informuese për të tretët.

Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit

Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. (*Kreu III Standardi V.1*)

AU ushtron veprimtarinë e tij në katër objekte të rindërtuara dhe rivlerësuara me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotësojnë tërësisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë.

AU është larg zonave të zhvillimit industrial apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse. Korpuset ndodhen në zonën e qendrës së Tiranës, dhe shumë pranë ndërtesave të karakterit rezidencial apo të shërbimeve të tjera për studentët.

Pjesa më e madhe e godinave janë të termoizoluara; shumica e dritareve të institucionit janë me dopio-xham jo vetëm për të siguruar temperatura të brendshme të qëndrueshme por gjithashtu për të evituar zhurmat nga jashtë. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme mirëmban dhe rikonstruktin ambientet të cilat shfaqin problematika në lidhje me izolimin për të shmangur lagështirën dhe jo vetëm.

Infrastruktura e Universitetit disponon të gjithë elementet e nevojshëm mësimore-shkencore universitare, si: ambiente për personelin akademik të pajisura me kompjutera, internet dhe të gjitha pajisjet e nevojshme; ambiente për personelin administrativ, klasa me hapësira të mëdha, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, ambiente për laboratorë të degëve të ndryshme, ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, salla kompjuterësh, salla për konferenca etj. (*Evidencë Nr. 2.22*)

Për programet e ofruara nga departamentet e Arkitekturës, Inxhinierive dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, institucioni siguron infrastrukturë adekuate për zhvillimin e laboratorëve dhe seminareve. (*Evidencë Nr. 2.25*)

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit që Universiteti ka me “Albanian College” në Tiranë, studentët e AU mund të shfrytëzojnë hapësirat sportive (fushë basketbolli, volejbolli, tenis,

palestër etj) të këtij kolegji për aktivitete/kampionate të ndryshme që zhvillohen gjatë vitit. **(Evidencë Nr. 2.26)**

AU plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me VKM Nr. 418 dt. 10.05.2017 për “Standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe degëve të tyre” .**(Evidencë Nr.2.22.e)**

AU për të gjitha programet e studimit të cilat kanë pjesë të kurrikulës formimin praktik të studentëve garanton kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e tyre. Për këtë janë bërë marrëveshje institucionale për praktikat e studentëve me institucione shtetërore dhe private si Arkiva e Shtetit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Bashkia Tiranë, Agjencia e Shërbimit të Sportit, Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" etj.**(Evidencë Nr. R.2.f)**

Lartësia e ambienteve të AU-së është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). Normativat minimale të mësipërme janë pranuar për programe studimi të tilla si anglisht, mësuesi, psikologji, shkenca ekonomike, shkenca juridike, etj (përgjithësisht për shkencat shoqërore). Për programe studimi në fushën e inxhinierisë, arkitekturës apo mjekësisë normativat e mësipërme janë respektuar dhe në një pjesë të rasteve janë thujse të dyfishuara.

AU në pjesën më të madhe të hapësirave plotëson normativat teknike të ndriçimit natyror, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15-20%) të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi në pjesën më të madhe të rasteve është i orientuar nga krahu i majtë i studentit.

Për fakultetet që kanë më shumë se 200 studentë dhe nuk disponojnë shkallë emergjence, ka dalje dytësore, të cilat mund të konsiderohen si dalje emergjence.

AU disponon certifikatat dhe aktet teknike për mbrojtjen kundra zjarrit për godinat e institucionit dhe disponon sistemin e mbrojtjes kundra shkarkimit elektrik.

AU në pjesën më të madhe të godinave të tij ka funksional sistemin e ngrohjes qendrore me kaldajë apo impiante kondicionimi. Gjithashtu, AU ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (gjenerator) si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit (depozita uji) duke lejuar të pandërprerë sigurimin e energjisë dhe ujit.

Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike. (Kreu III Standardi V.2)

Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga AU kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

AU ka si strukturë përgjegjëse Zyrën e Arshivës dhe Protokollit, për ruajtjen e dokumentacionit të të gjitha veprimtarive të rëndësishme të institucionit, sipas rregullores së universitetit.

Dokumentacioni ruhet dhe mirëmbahet në letër (hardcopy) dhe në version elektronik.

AU disponon bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, të dhënat personale, etj. në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe duke respektuar kuotat e kriteret e përcaktuara nga vetë Universiteti dhe të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe

Rinisë, për programet e studimeve që ofron. (*Evidencë Nr. 2.27*)

Këto të dhëna janë të depozituara në strukturat përkatëse duke nisur me “Zyrën e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve”, Sekretaritet dhe Kryesekretaritet e Fakulteteve si dhe zyra e Administratorit të përgjithshëm.

Procesi i informimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj realizohet nga, Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve si dhe sekretaritet dhe Kryesekretaret. Informacioni, për kriteret dhe procedurën e aplikimit gjithashtu mund të merret edhe online në faqen zyrtare, si dhe në broshurat informuese që përmbajnë të gjitha programet e studimit.

Kriteret dhe procedurat e hollësishme të transferimeve përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të AU, në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Trasferimeve si dhe në Rregulloret e programeve të studimit. (*Evidencë Nr. 2.28*)

Institucioni disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve.

Pranë Zyrës së Kryesekretarit të Fakulteteve gjenden për çdo program studimi në formë të shkruar dhe elektronike:

1. regjistra themeltarë, në të cilat pasqyrohen, të dhënat personale të studentëve, numra matrikullimi, formën e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme, dhe ecurinë nga data e regjistrimit deri në diplomim të studentit;
2. regjistra notash me vlerësimet e fituara nga studenti gjatë kohës së studimeve;
3. Fletëve të Provimit.

Administratori i Përgjithshëm i universitetit është struktura përgjegjëse për përpunimin dhe nxjerrjen e statistikave, qofshin këto vjetore apo ndër vite, sipas kërkesave të institucionit dhe MASR.

Informacioni fillestar për mbledhjen e statistikave vjen nga sekretaria mësimore. Administratori i përgjithshëm :

1. Mban ndër vite të dokumentuara të dhëna të detajuara për studentët e regjistruar, studentët e transferuar, studentë të huaj, studentë të mbetur në stazh, studentë të larguar dhe studentë që janë diplomuar për çdo program studimi;
2. Harton dhe ruan regjistrat e diplomave si dhe protokollin hyrës dhe dalës;
3. Lëshon diplomat të shoqëruara me suplement dhe listë notash.

Diplomat dhe suplementet shpërndahen vetëm në formën e shkruar. Suplementi i diplomës është në dy gjuhë.

Në Rregulloren e AU parashikohen në veçanti, natyra, niveli, përmbajtja dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fusha e punësimit.

Përfundimet dhe Vlerësimi

GVB nxjerr si përfundim se menaxhimi i burimeve njerëzore është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vërehet një përpjekje serioze dhe cilësore për të ndërtuar një sistem të përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, por edhe atij ndihmës akademik mbi bazën e korrektësisë, transparencës, meritokracisë dhe cilësisë së zhvillimit të programit të studimit. AU përdor metodologji vlerësimi për të gjithë veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore që janë pjesë e punës së përgjithshme të institucionit. Po ashtu, mundëson trajnimin e personelit të tij akademik dhe ndihmës akademik me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale.

Dokumentacioni i lidhur me të dhënat financiare është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike të cilave u është nënshtruar institucioni.

Universiteti mbështetet në kapacitetet e brendshme dhe të jashtme për miratimin e çështjeve buxhetore. Përdorimi i burimeve financiare është subjekt i rishikimit dhe i monitorimit të vazhdueshëm.

AU punon për ruajtjen, vlerësimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e fondit dokumentar dhe arkivor të trashëgimisë së vet akademike, kulturore dhe shkencore edhe në rrugë elektronike si dhe nëpërmjet televizionit UTV News, si një pasuri që duhet të trashëgohet.

Institucioni ofron një infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore në funksion të programeve të studimit që ofron.

3 – FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

Programet e studimeve të ofruara

AU ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij.

(Kreu I Standard I.1)

Programet e studimeve organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme, në zbatim të Statutit të AU (*Evidencë Nr.1.1, Neni 55*), në përputhje me vizionin dhe misionin e Institucionit, si dhe Strategjinë e Zhvillimit Institucional. (*Evidencë Nr.1.19 & Evidencë Nr.1.4, Kreu IV, Neni 36*) Për vitin akademik 2018-2019, AU ka ofruar në total 42 programe studimi, si më poshtë vijon:

- 16 programe të ciklit të parë *Bachelor*
- 12 programe të ciklit të dytë *Master Profesional* (me kohëzgjatje 1 vjeçare)
- 2 programe të integruara *Master i Shkencave* (me kohëzgjatje 5 vjeçare)
- 7 programe të ciklit të dytë *Master i Shkencave* (me kohëzgjatje 2 vjeçare)
- 1 program i ciklit të tretë *Specializim Afatgjatë* në fushën e Stomatologjisë
- 4 programe të ciklit të tretë *Doktoratë*

Për vitin akademik 2019-2020, AU ka aplikuar pranë MASR për hapjen e 9 programeve të reja të studimit. (*Evidencë Nr. 1.33*)

Lista e programeve aktive që ofron secili departament miratohet me Vendim Senati Akademik përpara fillimit të çdo viti akademik. (*Evidencë Nr. 3.1*) Në të njëjtën kohë, programet dhe planet e tyre mësimore përditësohen në faqen web të universitetit (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/category/programe-studimi/>), publikohen në broshura

informuese, manifestin akademik, si dhe në kanal televiziv UTV news (<http://www.utv-news.tv/>). **(Evidencë Nr. 1.27 & Evidencë 3.2)**

Kuotat dhe kriteret e pranimit për kandidatët për studentë në AU, miratohen me Vendim Senati Akademik, në mbështetje të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe në përputhje me propozimet e Departamenteve në AU. **(Evidencë Nr. 3.3, Evidencë nr. 1.7 Neni 3, pika 2/a)**

Gjatë periudhës Shkurt-Qershor, drejtuesit e departamenteve, në bashkëpunim me anëtarë të personelit ndihmës akademik, Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, si dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumni, realizojnë takime informuese me maurantët për ofertën akademike, si dhe mundësitë që ofron “Albanian University” për edukimin në të tri ciklet e studimit. **(Evidencë Nr. 3.4)** Gjithashtu, AU organizon Open Days, gjatë të cilave fton maurantët dhe studentët në ambientet e secilit Fakultet, për t’u njohur nga afër edhe me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën në mbështetje të mësimdhënies, apo mundësitë që ofron tregu i punës. **(Evidencë Nr. 2.7)** Informimi i studentëve është një proces i vazhdueshëm në AU, duke filluar që në periudhën e aplikimeve dhe regjistrimeve, në të cilën anëtarë të personelit akademik dhe ndihmës-akademik orientojnë studentët kandidatë duke i informuar më shumë mbi programet e studimit dhe duke vazhduar gjatë gjithë viteve universitare me këshillimin mbi zhvillimin e karrierës së tyre.

Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve.

(Kreu I Standardi I.2)

Aktualisht, AU ofron vetëm programe studimi me kohë të plotë. AU prej vitesh ka organizuar trajnime, workshope, evente shkencore duke bërë të mundur që studentët dhe profesionistët pjesëmarrës në këto aktivitete të certifikohen dhe të vlerësohen me kredite në profesionet e rregulluara si: Stomatologji, Infermieri, Farmaci. Risi për këtë vit akademik është dhe ofrimi i programeve të Edukimit në Vazhdim, për *Alumnit* e AU si edhe për profesionistët e profesioneve të rregulluara, për ti mbajtur ata në hap me zhvillimet e fundit të shkencës dhe teknologjisë. **(Evidencë Nr. 3.5)** Gjithashtu, falë eksperiencës pozitive dhe besueshmërisë që Institucioni ynë ka fituar në seriozitetin e organizimit të konferencave shkencore, Qendra Kombëtare e Edukimit në vazhdim ka miratuar “*Statusin e ofruesit të akredituar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, për profesionistët e shëndetësisë*”, duke nisur nga viti akademik 2018-2019. **(Evidencë Nr. 3.6)**

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.

(Kreu I Standardi I.3)

Programet e studimit në AU ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional dhe vlerat që ndan institucioni. **(Evidencë Nr. 1.19)**

Një ndër objektivat më të rëndësishme në planin strategjik të zhvillimit të AU 2017-2022 është konsolidimi dhe përmirësimi i programeve të studimit që ofron në përputhje me objektivat e formimit dhe impaktit shoqëror. Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti, AU ka hartuar plan veprimin duke përcaktuar masat si më poshtë:

- Rishikimi i kurrikulave të programeve të studimit;
- Përshtatja e programeve sipas kuadrit të ri ligjor; **(Evidencë Nr. 1.21)**

Bazuar në këtë plan, gjatë 2 viteve të fundit akademike, AU është kujdesur që të gjitha programet e studimit që ofron të rishikohen në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, si VKM Nr.41, datë.24.01.2018 dhe Udhëzimi Nr. 31 datë 29.12.2017. Kështu, ka realizuar me sukses jo vetëm përshtatjen e programeve të studimit sipas kuadrit të ri ligjor

(riorganizimi i programeve Master Profesional dhe SPA), por edhe ka rishikuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuara nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit, të gjitha programet që ofron, deri në masën e lejuar 20%. (*Evidencë Nr. 3.7 & Evidencë Nr. 1.30*)

Procedura e rishikimit të kurrikulave ka iniciuar me ngritjen në nivel njësie bazë të grupeve ad-hoc, pjesë e të cilave janë edhe anëtarët e Grupeve të Sigurimit të Cilësisë në departamentet përkatëse (*Evidencë Nr. 3.8*). Ky proces realizohet nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave (ZZhK), e cila ofron asistencë teknike si dhe rekomandime (*Evidencë Nr. 1.4, neni 16; Evidencë Nr. 3.9*). ZZhK i ka mundur të gjitha njësitë bazë një format të ri të planit mësimor të detajuar duke i ardhur në ndihmë grupeve të punës në përmbushjen e kriterëve për elementët e programeve të studimit. Në të njëjtën kohë, ZZhK ka rishikuar formatin e syllabuseve/programit lëndor, sipas përcaktimeve të VKM Nr.41, shtojca 2, duke mundur kështu unifikimin e kurrikulave dhe syllabuseve në nivel Institucional. (*Evidencë Nr. 3.7 aneks I&2*) Kështu, të gjitha syllabuset janë përditësuar në përputhje me ndryshimet në planet mësimore, si dhe duke vënë theksin tek ofrimi i literaturave bashkëkohore. (*Evidencë Nr. 3.10*) Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, pranë AU është ngritur edhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (KKM). (*Evidencë Nr. 3.11*) Të gjitha propozimet e njësitë bazë janë shqyrtuar nga KKM, janë miratuar nga Senati Akademik në AU, si kanë marrë miratimin përkatës nga MASR.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
(Kreu I Standardi I.4)

Arsimimi në AU organizohet i koordinuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe në bashkërendim me MASR. Gjithashtu, AU ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit, në përputhje me procesin e Bolonjës, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Në hapjen e programeve të reja të studimit por edhe në përditësimin e tyre janë marrë në konsideratë objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime tregu ku përfshihen të gjithë aktorët siç janë stafi akademik dhe specialistë të fushës, por edhe përfaqësues nga bizneset me qëllim përmirësimin e ofertës akademike në funksion të plotësimit të nevojave të tregut të punës. (*Evidencë Nr. 1.30*)

Në këtë kuadër, synohet formimi i një qytetari të denjë i cili është i përgatitur për tregun e punës në një shoqëri globale, i shërben ekonomisë duke përdorur dijet dhe teknologjinë si mjet i domosdoshëm, por njëherazi promovon nëpërmjet kontributit të tij një zhvillim të qëndrueshëm në shoqëri duke u karakterizuar nga vlerat qytetare dhe integriteti.

Gjithashtu, për të realizuar objektivin e mësipërm përveç qëllimeve dhe misionit që kanë programet e studimit, vend të rëndësishëm luajnë edhe veprimtaritë e bashkëpunimit me universitete brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë si qëllim diskutimin e çështjeve aktuale që i përkasin vendit tonë siç janë: problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt sfidave të BE, sfidat në sistemin shëndetësor, reformat në sistemin e drejtësisë, zhvillimi ekonomik, arsimi dhe e ardhmja e tij si dhe veprimtari dhe diskutime që janë lidhur me zhvillimin e artit në të gjitha format e tij, etj. (*Evidencë Nr. 2.8*)

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.
(Kreu I Standardi I.5)

AU bazuar në kapacitetet fizike dhe njerëzore realizon në mënyrë optimale programet e studimit në përputhje me kërkesat ligjore.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me nevojat e njësive bazë, mbështetur në kuadrin ligjor, duke konsideruar llojin e angazhimit në universitet të stafit akademik, kualifikimin dhe përvojën në mësimdhënie. *(Evidencë Nr. 3.12)*

Në aneks kontratat individuale të punës së personelit akademik përcaktohet ngarkesa semestrale. Është në interes të institucionit balancimi i ngarkesës dhe veprimtarive të tjera në universitet që lidhen me kërkimin shkencor dhe detyra të tjera të stafit akademik. *(Evidencë R.1.c)*

Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuar qartë. (Kreu I Standardi I.6)

Lista e programeve të studimit, planet mësimore, ngarkesa me kreditë, objektivat e tyre formuese, si dhe informacion mbi licensimin dhe akreditimin e tyre, publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Kështu, çdo student apo kandidat për student ka mundësi të informohet në çast për ofertën akademike në AU. (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/category/programe-studimi/>) Gjithashtu, gjatë periudhës së aplikimeve dhe regjistrimeve personeli akademik dhe ndihmës akademik këshillon dhe orienton studentët mbi programet e studimit të ofruara dhe çdo detaj tjetër që lidhet me jetën universitare. *(Evidencë Nr. 3.2 & Nr. 1.27)*

Gjatë javës së parë të orientimit, studentëve të viteve të para ju ofrohet informacion më i detajuar mbi strukturën organizative të Institucionit, kalendarin akademik, orarin mësimor, organizimin e programit mësimor, si dhe rregulloret përkatëse ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e studentit gjatë kohës së studimeve në AU. Studentët, gjithashtu në departament mund të tërheqin kopje të syllabuseve të lëndëve ku janë të detajuara qartë përmbledhje dhe rezultate të të nxënit, temat e lëndës për gjatë gjithë kohështrirjes, literatura dhe format e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. *(Evidencë Nr. 3.13)*

Në rregulloret mësimore të çdo programi studimi të ofruar në AU, janë të specifikuar qartë objektivat e programit përkatës. *(Evidencë Nr. 3.14, Kreu II, neni 4)*

Kriteret e pranimit, dokumentet, dhe procedura e aplikimit gjenden të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/>) Për çdo paqartësi apo informacion shtesë, aplikantët mund të kontaktojnë edhe në portalin e aplikimit universitar UAlbania

(<https://ualbania.arsimi.gov.al/Universitet/Index/53>), si dhe pranë “Zyrës së Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve” në AU.

Programet e studimeve të Ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme. (Kreu I Standardi I.7)

Programet e studimit janë hartuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë kalimin nga Cikli i parë i studimeve në Ciklin pasardhës duke siguruar koherencë dhe vazhdimësi në përmbajtje.

Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, kanë për qëllim të pajisin studentin me njohuri dhe koncepte bazë, me aftësi analike, krijuese, vendimarrëse, duke u bazuar në metoda shkencore dhe të përgjithshme. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të parë studentit i duhet të fitojë minimalisht 180 kredite ECTS. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë, studenti ka të drejtë

të diplomohet dhe të fitojë diplomën “Bachelor”.

Programet mësimore hartohen në mënyrë të tillë që t’u ofrojnë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme për integrimin e tyre në tregun e punës dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjen kërkesave me të cilat ato do të përballen gjatë realizimit të tyre profesional. **(Evidencë Nr. 3.15, Kreu II, neni 4)**

Mundësitë e punësimit të studentëve që përfundojnë studimet në AU përcaktohen qartë që në hapje të programit të studimit, publikohen në web, si dhe në manifestin akademik. (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-edukimit-dhe-anglishtes/>) Që në momentin e regjistrimit, studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit pas diplomimit, akreditimin e institucionit dhe të programit të studimit që ofrohet si edhe njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga Albanian University. **(Evidencë Nr. 3.15, Kreu III, neni 11)**

Në zbatim të ligjit, akteve nënligjore në fuqi, si dhe akteve normative të institucionit studentët informohen dhe orientohen mbi mundësitë e transferimit të studimeve sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e “Regjistrimeve dhe Transferimeve”. Në këtë rregullore detajohen kriteret, dokumentacioni dhe procedura e njohjes së krediteve. **(Evidencë Nr. 2.28, Kreu III)**

Programet e studimeve të Ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambientimi i studentit me mjedisin universitar. (Kreu I, Standardi I.8)

AU i ofron studentëve prej vitesh shërbimin e mbështetjes ndaj studentëve si dhe këshillimin për karrierën. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët në bashkëpunimin dhe me departamentet i informojnë studentët mbi mbarëvajtjen e procesit akademik, i nxitin ato për një pjesëmarrje sa më aktive në jetën universitare nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare, i mbështesin për të vazhduar aftësimin e tyre profesional gjatë gjithë jetës, nëpërmjet informimit mbi mundësitë për trajnime, internshipe, bursa etj. **(Evidencë 3.16, neni 2,3,4).**

Zyra e karrierës dhe Alumnit zhvillon lidhjet mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, me botën e biznesit. Gjithashtu shërben si ndërlidhëse dhe ndihmon konsultat e studentëve me pedagogët dhe asistentë pedagogët mbi informacionet akademike. Nëpërmjet kësaj zyre studentët këshillohen se si të bëjnë aplikime të ndryshme për shkollat verore, specializime, mastera, vende pune. **(Evidencë Nr.1.19. pika 5, fq.21)** Zyra e Karrierës dhe Alumni ndjek ecurinë e studentëve të diplomuar duke përditësuar në mënyrë periodike databasën e punësimit të Alumnit të saj. **(Evidencë Nr. 3.17, neni 3)**

Metodat e mësimdhënies janë në përputhje me fushën e studimit dhe në të gjitha rastet ato janë të kombinuara që mësimdhënia të jetë sa më dinamike me studentin në qendër të procesit mësimor.

Personeli akademik është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Marrëdhëniet e punësimit të personelit akademik në AU, rregullohen bazuar në kontratën individuale të punës, bazuar në Kodin e punës dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në fuqi. **(Evidencë Nr. 1.1, neni 35, 36)** Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, AU kujdeset që së paku 70 % e ngarkesës mësimore në të gjitha programet e ciklit të parë të zhvillohet nga personeli akademik efektiv.

Programet e studimeve të Ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike. (Kreu I Standardi I.9)

Programet e studimit të Ciklit të dytë synojnë zgjerimin e njohurive, thellimin më të plotë në kompetencat praktike dhe realizimin e detyrave/projekteve kërkimore shkencore. Programet e studimeve hartohen nga grupet ad-hoc' të ngritura në nivel departamenti, të cilat përbëhen nga anëtarë të Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti, personel akademik me arritje të rëndësishme në fushën e kërkimit shkencor, personel akademik që janë të lidhur ngushtë me zhvillimet e tregut të punës, apo edhe përfaqësues të bizneseve (*Evidencë Nr. 1.31*). Propozimet e grupit të punës janë objekt diskutimi në mbledhjet e departamentit ku mund të japin sugjerime të gjithë anëtarët e personelit akademik.

Procesi i diplomimit të studentëve që ndjekin një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” realizohet me anë të mbrojtjes së diplomës me projekt/studim, tema e së cilës miratohet nga departamenti brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik. Projekti i diplomës mund të udhëhiqet nga një ose dy udhëheqës, dhe përparësinë e kanë anëtarët e personelit akademik efektiv të Departamentit si dhe specialistë të angazhuar në veprimtari kërkimore shkencore. (*Evidencë Nr. 3.14 Kreu V, neni 30*)

Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë kanë të parashikuar në planin mësimor edhe praktikën profesionale, ngarkesa e të cilës është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. AU i ka kushtuar një rëndësi të veçantë organizimit të praktikës profesionale, duke i mundësuar studentëve realizimin në mënyrë korrekte, brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në sajë edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit që AU ka nënshkruar me institucionet e praktikave siç janë qendrat spitalore, bizneset, institucionet kërkimore, institucione shtetërore dhe private, etj. (*Evidencë R.2.f*) Studentët ndiqen në vijimësi nën drejtimin e një pedagogu të përcaktuar nga departamenti përkatës. (*Evidencë Nr. 3.18 Kreu IV, neni 27*) Institucioni pritës bazuar në politikat e tij cakton një ë i cili mbikëqyr studentët gjatë orarit të praktikës profesionale.

Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me *Alumnit* e saj dhe me urdhërat e profesionistëve, si: Urdhri i Farmacistit, i Stomatologut, Infermierit, Psikologut, për të marrë një informacion sa më të plotë mbi punësimin dhe shpërndarjen e studentëve. (*Evidencë Nr. 1.34*)

AU angazhon në mësimdhënie personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel të ftuar në programet e Ciklit të dytë dhe të tretë, të cilët janë specialistë të fushave përkatëse dhe përfaqësues të bizneseve apo fushave të tjera, si në rastin e programeve në shkencat mjekësore ku pjesë e stafit janë mjekë specialistë të angazhuar në spitalet rajonale në Tiranë, si QSUT, Spitali Ushtarak, etj. Gjithashtu, AU ka angazhuar personel akademik të huaj në mësimdhënie. (*Evidence Nr. 1.39*)

70 % e ngarkesës mësimore në të gjitha programet e Ciklit të dytë zhvillohet nga personeli akademik me kohë të plotë.

Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. (Kreu I Standardi I.10)

Të gjitha programet e ofruara në AU janë të organizuara në përputhje me procesin e Bolonjës, duke realizuar ndarjen në module me përmbajtje të detajuar dhe vlerësuar me kredite (ECTS). Programet e studimit hartohen dhe rishikohen në mënyrë që të kenë ngjashmëri me programe brenda dhe jashtë vendit duke bërë të mundur njëkohësisht njohjen dhe transferimin e studimeve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës, i cili ofrohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht). (*Evidencë Nr. 3.19, a, b*)

AU publikon në faqen web www.albanianuniversity.edu.al informacion të plotë mbi programet e studimit të ofruara, kurrikulat dhe kriteret e pranimit, në gjuhë shqipe dhe angleze. Gjuha angleze është pjesë e planit mësimor që në vitin e parë në programet bachelor. Gjithashtu institucioni ofron kurse suplementare të gjuhës gjermane për studentët e Fakultetit të mjekësisë. (*Evidencë Nr.3.20*) Studentët e programeve Master i shkencave dhe programeve të ciklit tw tretë tw studimit rekomandohen të përdorin edhe literaturë në gjuhë të huaj. Ata kanë detyrim të dorëzojnë gjatë studimeve ose në përfundim dëshminë e mbrojtjes së njërës prej 5 gjuhëve të huaja, sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të certifikuar në nivelin internacional. (*Evidencë nr. – 3.14 Kreu III, neni 9*)

Studentët kanë mundësi të transferojnë studimet në AU si dhe kreditet e fituara në programe të të njëjtit cikël, në RSh apo jashtë saj, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në përputhje me rregulloren përkatëse të studimit. (*Evidencë Nr. 2.28 & Evidencë Nr. 3.21 & Evidencë Nr. 3.22*) Gjithashtu, AU angazhohet edhe në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në gjuhë të huaj, në kuadër të transferimit të studimeve apo regjistrimit në një cikël tjetër jashtë vendit.

Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. (Kreu I Standardi I.11)

Të gjitha programet e studimit në AU kanë të ndërthurura njohuritë teorike dhe ato praktike, duke i mundësuar studentëve aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në modulet teorike, si dhe duke u udhëhequr nga kompetencat që duhet të fitojë studenti në secilin program studimi.

Gjatë vitit akademik studentët aftësohen për kryerjen e veprimtarive të ndryshme mësimore si projekteve kërkimore, detyrave të kursit, punëve praktike, punëve laboratorike, projekteve të ndryshme sipas disiplinave mësimore. Në përfundim të programit të studimit “Master i Shkencave”, studenti ka fituar aftësitë e duhura për shkrimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës.

Universiteti mbështet pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare, si: leksione të hapura, tryezat e rumbullakëta, klubet studentore, konferenca studentore, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, workshope, duke i mundësuar kështu aplikimin e njohurive dhe aftësive të fituara., etj (*Evidencë Nr. 2.8; Evidenca 2.9.e*)

Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim. (Kreu I Standardi I.12)

Të gjitha programet e studimit të ofruara në AU kanë për qëllim të formojnë specialistë në fushat e studimit të cilët do të kontribuojnë për një zhvillim të qëndrueshëm në shoqërinë dhe ekonominë shqiptare.

Programet e studimit që ofrohen nga AU përfshijnë njohuri për sipërmarrjen, praktika profesionale, të cilat janë të shtrira për gjatë gjithë vitit në programe të caktuara ose të grumbulluara në fund të semestrit që zhvillohen pranë institucioneve të përcaktuara nga departamenti.

Programet e studimit kanë të parashikuar veprimtari mësimore në funksion të formimit praktik profesional si punët laboratorike, ushtrimet, detyra/projekte si dhe praktikat profesionale në terren.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm pasi konsultoi gjithë dokumentacionin mbi programet e studimit të ofruara në AU, organizimin dhe implementim e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, vlerëson se standardet për fushën e kurrikulave përmbushen plotësisht.

Të gjitha programet e studimit ofrohen në përputhje me misionin, strategjinë e zhvillimit të AU, kapacitetin intelektual dhe infrastrukturor të tij, duke konsideruar politikat ndërkombëtare dhe kombëtare të zhvillimit të Arsimit të Lartë si dhe eksperiencat më të mira të universiteteve në botë. Studentët informohen vazhdimisht për programet që ofrohen përmes faqes Web të AU si dhe mjeteve të tjera të informimit.

Të gjitha programet janë hartuar/ rishikuar dhe përmirësuar nga ekspertët më të mirë të fushave në përputhje me ndryshimet e diktuar nga legjislacioni në fuqi. Programet pasqyrojnë një gërshetim shumë të mirë të njohurive teorike dhe praktike me objektivin për të orientuar sa më mirë studentët drejt tregut dinamik të punës në një shoqëri globale.

4- FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

Organizimi i Programeve të Studimeve

Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme. (Kreu I Standardi II.1)

Institucioni punon në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar një organizim dhe dokumentim sa më korrekt dhe efikas të planeve mësimore të programeve të studimit që ofron. Dokumentacioni ruhet në departament, si dhe arkivohet në format elektronik pranë Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave (*Evidenca Nr. 3.9, neni 6, pika 2, fq.3*). Programet e studimit, sipas fakulteteve, publikohen në faqen zyrtare të Institucionit (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/manifesti-akademik/>).

Personeli akademik angazhohet në grupet e ekspertëve në kuadër të rishikimit të kurrikulave (*Evidenca Nr. 3.8*) dhe në hartimin e kurrikulave të reja (*Evidenca Nr. 4.1*) në përputhje me

misionin dhe qëllimet e Institucionit, strategjinë për zhvillim të tij, si dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës. Çdo fillim viti, nën kujdesin e koordinatorëve të grupeve mësimore (*Evidenca Nr. 4.2 Neni 11, fq. 6*), personeli akademik angazhohet në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, me qëllim pasurimin dhe përditësimin e tyre bazuar në të rejtat më të fundit në fushat përkatëse (*Evidenca Nr. 3.10*).

Në funksion të programeve të studimit të ofruara, institucioni vë në dispozicion një sërë laboratorësh mësimorë (*Evidenca Nr. 2.25*). Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Punët laboratorike, kryhen në prani të pedagogut të laboratoreve dhe laborantit (në funksion të tipologjisë së laboratoreve), për një mbarëvajtje sa më të mirë të tyre.

Pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në kuadër të programit të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Stomatologji” dhe Specializimeve afatgjata në fushën e Stomatologjisë, funksionon edhe Klinika Universitare Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj” (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-universitare-2/>).

Po në këtë Fakultet në kuadër të programit të studimit *Bachelor* në “Fizioterapi” dhe Masterit Profesional në “Terapi Manuale”, që prej vitit 2016, është ngritur Klinika e Fizioterapisë (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-e-fizioterapise/>). Praktikantët mësimorë/profesionale realizohen në bashkëpunim me institucione/kompani/organizata me të cilat *Albanian University* ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga departamenti, i cili mbikqyr realizimin e praktikës nga ana e studentit (*Evidenca Nr. 3.15, Neni 27, fq. 21, Evidenca Nr 3.18, Neni 27, fq. 17, Evidenca R.2.f, Evidencë 4.3, Evidencë 4.4*).

Institucioni nëpërmjet pedagogëve udhëheqës ndjek nga afër praktikantët, projektet/detyrat, temat e diplomave. Për studentët, të cilët diplomohen me provim formimi organizohen takime informuese mbi mënyrën e organizimit të provimit. Gjithashtu, gjatë semestrit të dytë, pedagogët e lëndëve, të cilat do të jenë të përfshira në provimin e formimit, organizojnë herë pas here takime me studentët e vitit të tretë për t’i udhëzuar mbi to (*Evidenca Nr. 3.15, Neni 29, fq. 22*).

Për studentët, të cilët diplomohen me temë diplome, departamenti përcakton pedagogun udhëheqës (*Evidenca Nr 3.18, Neni 29, fq. 18, Evidenca Nr.3.14, Neni 31, fq. 24, Evidencë 4.5*). Studentëve ju janë vënë në dispozicion Manuale për përgatitjen e diplomave, në përputhje me programin dhe ciklin e studimeve (*Evidencë Nr. 4.6*).

Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturën e nevojshme, e cila pasurohet çdo fillim viti akademik me tituj bashkëkohorë (*Evidencë Nr. 4.7*). Pedagogët orientojnë studentët për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekat e universitetit (*Evidenca Nr. 4.8*), si dhe në libraritë online (*Evidencë Nr. 4.9*).

Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. (Kreu I Standardi II.2)

Organizimi i provimeve bëhet në përputhje me Rregulloren e Sekretarisë Mësimore (*Evidencë Nr. 4.10, Neni 7, faqe 5, https://albanianuniversity.edu.al/sq/sekretaria-mesimore/*), Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit (*Evidencë Nr. 1.4, Neni 52, fq. 38*) dhe rregulloret e programeve të studimeve (*Evidencë Nr. 3.15, Neni 18, fq. 14, Evidencë 3.18, Neni 19, fq. 12, Evidencë 3.14, Neni 21, fq. 19*).

Institucioni informon studentët diplomantë me procedurat e mbrojtjes së diplomës me provim

formimi apo me temë diplome bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit (*Evidencë 3.15, Neni 29, fq. 22, Evidencë 3.18, Neni 29, fq. 18, Evidencë 3.14, Neni 31, fq. 24*). Studentëve diplomantë, ju vihet në dispozicion baza e pyetjeve të provimit të formimit. Studentët që diplomohen me temë diplome, duhet të aplikojnë pranë strukturës përgjegjëse të programit të studimit për zgjedhjen e temës/projektit të diplomës (*Evidencë 4.5*). Studentëve gjithashtu, ju vihet në dispozicion nga departamenti përkatës, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe në faqen *web* të Institucionit, udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=Manual+per+teme+diplome>).

Gjatë procesit të provimeve me shkrim ruhet anonimiteti, përmes sekretimit të provimeve (*Evidencë Nr. 3.15, Neni 20, pika 2, fq. 17, Evidencë Nr. 3.18, Neni 21, pika 2, fq. 14, Evidencë Nr. 3.14, neni 23, pika 2, fq. 21*). Brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit, provimet e korrigjuara nga pedagogu përgjegjës depozitohen pranë departamentit, ku bëhet ç'sekretimi i tezës (*Evidencë Nr. 3.15, neni 23, fq. 18, Evidencë Nr. 3.18, neni 23, fq. 14, Evidencë Nr. 3.14, neni 26, fq. 22*).

Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision *ad hoc* në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korrigjuar provimet (*Evidencë Nr. 3.15, neni 23, pika 3 - 4, fq. 18, Evidencë Nr. 3.18, neni 23, pika 3 - 4, fq. 14, Evidencë Nr. 3.14, neni 26, pika 3 - 4, fq. 22*). Vlerësimi i provimeve i bëhet i njohur studentëve nga sekretaria mësimore duke respektuar parimin e konfidencialitetit, si dhe përmes sekretarisë *online* (<http://on.albanianuniversity.edu.al/login>) ku çdo student mund të informohet me anë të llogarisë personale mbi ecurinë e studimeve dhe rezultatet e provimeve.

Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë. (*Kreu I Standardi II.3*)

Vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik në *Albanian University*, bazohet në kriteret e mëposhtme:

- **Vlerësim nga njësia kryesore** (*Evidencë Nr. 4.11*) mbi bazën e raportit të hartuar nga njësia bazë (*Evidencë Nr. 4.12*) në të cilin përfshihen të dhëna përshtetëse dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen,
- **Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit** (*Evidencë Nr. 2.13*) – çdo fund viti drejtuesi i departamentit, harton një raport përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimi përmes raportit semestral të hartuar nga pedagogët (*Evidencë Nr. 4.13*) vlerësimi i drejtuesit të departamentit mbi angazhimin në çështjet administrative të departamentit, mbi veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe trajnimet e pedagogut, bazuar në vetë - deklaratimet e tyre përmes formularit të veprimtarisë kërkimore - shkencore (*Evidencë Nr. 4.14*)
- **Vlerësim nga pedagogët** - për herë të parë gjatë vitit akademik 2018 – 2019, pedagogët i janë nënshtruan një pyetësori, përmes të cilit shprehën mendimet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të punës në Universitet (*Evidencë Nr. R.1.d*)

- **Vlerësim nga studentët** nëpërmjet pyetësorëve, 2 herë në vit, një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të dytë (<https://forms.gle/mP6KY5Lq4LAMRo3E8>) (*Evidencë Nr. 4.15*), gjithmonë përpara sezonit të provimeve, dhe fokus grupeve që organizohen nga NJSBC sipas axhendës së tyre (*Evidencë Nr. 4.16,a,b*),
- **Rishikim i kurrikulave dhe i syllabuseve** - të gjitha programet e studimit rishikohen në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave (*Evidencë Nr. 3.15, Neni 6, fq. 6, Evidencë Nr. 3.18, neni 6, fq. 18, Evidencë Nr. 3.14, neni 6, fq. 5, Evidencë 3.8*) me qëllim azhornimin e tyre në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Referuar akteve të reja nënligjore, rishikimi i programeve të studimit për ndryshime të mundshme realizohet deri në muajin mars. Periudhë kjo në të cilën institucioni duhet të vërë në dijeni MASR për implementimin e këtyre ndryshimeve në vitin akademik pasardhës. Në grupet e ngritura për rishikimet e kurrikulave (*Evidencë Nr. 4.17*), marrin pjesë përfaqësues të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti (*Evidencë Nr. 1.12.b*), koordinatorët e grupeve mësimore përkatëse (*Evidencë Nr. 4.2 Neni 11, fq. 6*) dhe përfaqësues të biznesit. Gjithashtu, çdo fillim viti, nën kujdesin e koordinatorëve të grupeve mësimore (*Evidencë Nr. 4.2, Neni 11, fq. 6*), personeli akademik angazhohet në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, me qëllim pasurimin dhe përditësimin e tyre bazuar në të rejtat më të fundit në fushat përkatëse (*Evidencë Nr. 3.10*)
- **Statistika të Alumnit** mbi numrin e të punësuarve në përputhje me fushën e studimit (*Evidencë Nr. 1.34*),

Pasi janë marrë rezultatet nga të gjithë përbërësit e përmendur më lartë, NJSBC i paraqet Rektoratit vlerësimin duke hartuar raportin vjetor (*Evidencë Nr. 4.18*),.

Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. (*Kreu I Standardi II.4*)

Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (*Evidencë Nr. 1.4, Neni 14, 16, fq. 16 – 18*), si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (*Evidencë Nr. 1.4, Neni 15, fq. 18*).

Institucioni vë në dispozicion të mësimdhënies paketën Office 365 (*Evidencë Nr. 4.19*), një instrument për zgjerimin e mësimdhënies edhe *online*, për shpërndarjen e materialeve mësimore, zhvillimit të detyrave, komunikimit me studentët etj. Së fundmi, një grup pedagogësh kanë eksperimentuar me sukses në mësimdhënie, edhe përdorimin e platformës *open – access*, Google Classroom (*Evidencë Nr. 4.20*).

Institucioni inkurajon dhe kualifikon personelin akademik në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies duke ofruar programe studimi të ciklit të tretë “Specializime Afatgjatë” në fushën e Stomatologjisë dhe “Doktoratë” në disa drejtime (*Evidencë Nr. 4.21*).

Çdo fillim viti akademik ofrohen trajnime për metodologjinë dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, nga pedagogë të AU dhe specialistë të jashtëm (*Evidencë R.2.a & Evidencë Nr. 2.5*).

Pedagogë të huaj përfshihen në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe aktivitete të ndryshme si: konferenca, *workshop*-e, trajnime etj (*Evidencë Nr. 1.39*).

Institucioni ofron ambjente të përshtatshme në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies: të gjitha sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme imobiliare dhe me mjetet e

nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor, etj. Të gjitha godinat mbulohen nga rrjet interneti *wireless*, e disponueshme për të gjithë. Në bibliotekat e fakulteteve gjenden, në format *hardcopy*, titujt e librave kryesorë të literaturës së detyruar në syllabuset e lëndëve (**Evidencë Nr. 4.8**), si dhe dispensa të përgatitura nga pedagogët në gjuhën shqipe, bazuar në literaturë të huaj bashkëkohore. Çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve, departamentet bëjnë kërkesat e tyre për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër (**Evidencë Nr. 4.7**). Në ambjentet e bibliotekave, vihen në dispozicion të studentëve kompjutera/terminale, duke mundësuar kërkimin në *internet* dhe aksesimin e librarive *online* (**Evidencë Nr. 4.9**), të këshilluara nga departamenti përkatës.

Veprimtaria e personelit akademik, personelit ndihmës mësimor – shkencor dhe personelit administrativ (**Evidencë Nr. 1.1, Kreu IV, fq. 23**), është në funksion të mbarëvajtjes akademike dhe administrative të programeve të studimit të ofruara nga Institucioni.

Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre.

Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.1)

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive (**Evidencë Nr. 1.1, Neni 16, pika 1 - 2, fq. 8, & Evidencë Nr. 4.2, Neni 4, fq. 2**).

Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupet mësimore e kërkimore janë të përhershme, por ato mund të jenë edhe të përkohshme. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor (**Evidencë Nr. 1.1, Neni 16, pika 6, fq. 8, Evidencë Nr. 4.2, Neni 7, pika 2, fq. 4**).

Misioni i departamentit, si njësi bazë e Fakultetit, është të nxisë, bashkërendojë dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij (**Evidencë 1.4, Neni 25, pika 2, fq. 25, & Evidencë Nr. 4.2, Neni 3, pika 2.f, fq. 2**)

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti akademik më i lartë drejtues i njësisë bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton Dekanit (**Evidencë 1.4, Neni 26, pika 1, fq. 25, & Evidencë Nr. 4.2, Neni 9, pika 1, fq. 4**).

Përgjegjësi i departamentit harton programin vjetor dhe planin financiar të veprimtarive mësimore dhe kërkimore - shkencore (**Evidencë Nr. 4.2, Neni 9, pika 3.p, fq. 5**). Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur. Bordi i Administrimit, me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre (**Evidencë Nr. 1.1,, Neni 22, pika 4.c, fq. 14**). Në planin financiar institucional parashikohen fonde për kërkimin shkencor për çdo departament (**Evidencë Nr. 2.18**).

Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor. (Kreu II Standardi I.2)

Institucioni bashkëpunon me struktura kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të kërkimit shkencor (**Evidencë R.2.g dhe evidencë R.2.c**), me qëllim aplikimin dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta (**Evidencë 1.18**).

Institucioni mbështet dhe inkurajon stafin akademik dhe departamentet, në drejtim të Kërkimit Shkencor dhe projekteve, edhe përmes informimit dhe trajnimit (https://youtube/6JNQbd_w86Q, <https://youtu.be/q2tLBt8Y3OQ>)

Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit (*Kreu II Standardi I.3*)

Institucioni periodikisht, në nivel njësie bazë ose njësie kryesore, organizon Konferenca Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e akademikëve të shquar nga Universitete të njohura ndërkombëtare (*Evidencë Nr. 2.9.a*), duke sjellë tendencat më të fundit në fushën e kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit. Këto aktivitete, si dhe aktivitete të tjera si: *workshop*-e, leksione të hapura, trajnime etj. (*Evidencë Nr. 2.8- a,b*) mbajnë stafin akademik dhe atë ndihmës mësues të azhurnuar me të reja më të fundit në fushat përkatëse. Punimet kërkimore shkencore të personelit akademik të AU bëhen publike edhe nëpërmjet botimeve në revistën shkencore të AU “Optime” me ISSN 2220-461X dhe me bord editorial (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>).

Personeli akademik i Institucioni prezanton studimet e tij kërkimore – shkencore në Konferenca brenda dhe jashtë vendit, si dhe i publikon ato në revista të njohura të fushave përkatëse. Gjatë dy viteve të fundit, nga stafi akademik i AU, numërohen rreth 545 pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe rreth 238 publikime në revista ndërkombëtare (*Evidencë Nr. 4.22*)

Institucioni bashkëpunon me Institucione të huaja të Arsimit të Lartë në kuadër të kërkimit shkencor (*Evidencë R.2.c & R.2.g*) Bashkëpunimet janë në zgjerim të vazhdueshëm. Përmes tyre është mundësuar pjesëmarrja/aplikimi i Universitetit në disa programe Europiane të kërkimit shkencor dhe mobilitetit (Erasmus+, CEEPUS, Horizon 2020, Mevlana etj.).

Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor. (*Kreu II Standardi I.4*)

Çdo fillim viti, departamentet informojnë Zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor dhe Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike mbi temën qendrore të aktiviteteve shkencore përgjatë tij (*Evidencë R.4.c*), <https://youtu.be/dGgseuPuHzs>). Institucioni mbështet dhe nxit aktivitetet në drejtim të konkretizimit të tyre, edhe përmes favorizimit të debatit shkencor.

Institucioni mbështet stafin akademik dhe studentët në inovacion/shpikje. Institucioni ka mbështetur financiarisht pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Departamenti i Inxhinierive në aktivitetin Doku.tech në Prishtinë, Kosovë (*Evidencë Nr.4.23*), <https://albanianuniversity.edu.al/sq/doku-fest-doku-tech-prishtine-2019/>. Gjithashtu, studenti në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike, Bujar Dalipi është mbështetur në kuadër të projektit të tij BuNa me mentorim nga ekspertë të huaj të organizatës Swiss EP dhe në përfshirjen e programit të akselerimit Oficina.

Institucioni zbaton prioritetet kërkimore shkencore. (*Kreu II Standardi I.5*)

Institucioni mbështet dhe nxit me të gjitha mjetet zbatimin, zhvillimin dhe zgjerimin e fushave prioritare të përcaktuara nga departamentet (*Evidencë R.4.a & Evidencë R.4.c*) përmes financimeve, zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (*Evidencë R.2.c & Evidencë R.2.g*), përmes rekrutimeve të reja të personelit akademik të kualifikuar në kërkim shkencor, në funksion të strategjisë për zhvillim të Institucionit, përmes organizimit të aktiviteteve orientuese mbi programet Europiane të kërkimit shkencor dhe mobilitetit (https://youtu.be/6JNQbd_w86Q, <https://youtu.be/q2tLBt8Y3OQ>), përmes organizimit të Konferencave, *workshop*-eve, leksioneve të hapura etj. (*Evidencë 2.8 & 2.9-a*).

Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor. (*Kreu II Standardi I.6*)

Një nga objektivat strategjike të Institucionit është kërkimi shkencor dhe inovacioni (*Evidencë*

1.19, fq. 4).

Institucioni mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor në fushat prioritare, të përcaktuara edhe në funksion të kapaciteteve infrastrukturore (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/klinika-universitare-2/>), (*Evidencë Nr. 2.25*) dhe njerëzore të tij. Institucioni angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së kërkimit shkencor përmes investimeve dhe projekteve të fituara (*Evidencë Nr. 1.14, 1.15, 1.16, 1.17, 1.18*) dhe rekrutimeve të reja në përputhje me objektivat e zhvillimit të kërkimit shkencor.

Institucioni bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë. Për t'u përmendur këtu Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike (*Evidencë Nr. 4.24 & Evidencë Nr. 4.25*)

Studentët doktorantë kanë një pjesëmarrje aktive në veprimtarinë kërkimore – shkencore të Institucionit, jo vetëm në kuadër të studimit të tyre “Doktoratë”, por gjithashtu, në projekte të tjera, në të cilat Institucioni është i përfshirë (*Evidencë Nr. 4.26 & Evidencë Nr. 4.27*) Në këto projekte japin një kontribut aktiv edhe studiues të rinj, pjesë e stafit akademik të Universitetit.

Institucioni synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të OCDE-së, dhe të Bashkimit Evropian (*Evidencë Nr. 1.19, fq. 24*).

Institucioni fton dhe mirëpret vazhdimisht studiues të huaj në konferenca, leksione të hapura, trajnime, *workshop*-e etj. (*Evidencë Nr. 1.39*). Bashkëpunimi me ta është në zgjerim dhe forcim të vazhdueshëm.

Institucioni favorizon mobilitetin e personelit akademik, që angazhohet në veprimtari kërkimore – shkencore jashtë vendit (Evidencë Nr. R.1.e). Gjithashtu, ai mbështet stafin e tij në kualifikime të mëtejshme jashtë vendit. Vlejnë këtu për t'u përmendur mbështetja dhe politikat favorizuese për përfshirjen në programet “Doktoratë” jashtë vendit të disa anëtarëve të stafit akademik (Evidencë Nr. 4.28)

Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.7)

Institucioni mbështet dhe inkurajon organizimin e konferencave ndërkombëtare, leksioneve të hapura, *workshop*-eve etj. (*Evidencë Nr. 2.9-a & 2.8*).

Institucion mbështet publikimet shkencore të stafit akademik përmes financimeve (*Evidencë Nr. 4.29, Neni 11 - 13, fq. 5 - 6, & Evidencë 2.10*) dhe përmes revistës së saj “Optime” (<http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>). Gjithashtu, shtëpia botuese “AU Press” është një promovuese e mirë e veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit akademik të institucionit, duke mundësuar publikimin e librave apo monografive (*Evidencë Nr. 2.12*).

Aktivitetet shkencore të zhvilluara nga Institucioni kanë një ndikim pozitiv në kulturën kërkimore - shkencore shqiptare dhe rajonale. Pjesëmarrja në këto aktivitete e studiuesve të ndryshëm, nga Shqipëria, rajoni edhe më gjerë, është një tregues i qartë i saj. Institucioni promovon kulturën kërkimore - shkencore në nivel rajonal dhe kombëtar, edhe përmes bashkëpunimit të ngushtë me kanalën televiziv UTV News.

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. (Kreu II Standardi I.8)

Pranë Rektoratit, si njësi në funksion të procesit kërkimor - shkencor funksionon Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike (*Evidencë Nr.1.1, Neni 18, fq. 20*).

Përgjatë dhe në fund të çdo viti akademik, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike raporton për veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, ku dhe kryhen vlerësimet përkatëse (*Evidencë Nr. 4.30, Evidencë Nr.1.4, Neni 18, pika k, fq. 20, & Evidencë Nr. 4.29 Neni 8, pika n, fq. 5*).

Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të Universitetit, brenda dhe jashtë vendi (*Evidencë Nr.1.4, Neni 18, pika g, fq. 20*).

Institucioni ka një praktikë të mirë në veprimtarinë kërkimore – botuese, duke botuar të gjithë materialet e Konferencave përmes shtëpisë botuese “AU Press”, si dhe në revistës “Optime” <http://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>.

Institucioni mbështet dhe inkurajon stafin akademik në drejtim të kërkimit shkencor, pjesëmarrjes në projekte, si dhe publikimeve të rezultateve të tyre në konferenca dhe revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Institucioni bashkëpunon me biznese dhe organizata vendase dhe të huaj, duke rritur impaktin ekonomik dhe social të veprimtarive të tij kërkimore – shkencore (*Evidencë R.2.f & Evidencë Nr. 1.37*)

Institucioni vlerëson ecurinë e studimeve dhe kërkimeve shkencore të personelit akademik përmes raporteve vjetore nga njësia kryesore (*Evidencë Nr. 4.11*), bazuar në raportin e njëjësive bazë. Mbi bazën e tyre NJSBC harton raportin vjetor në nivel Institucioni (*Evidencë Nr. 4.18*). Në kuadër të këtij raporti, çdo anëtar i personelit akademik deklaron veprimtarinë kërkimore shkencore si: botime kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca dhe projekte të fituara etj. (*Evidencë Nr. 4.14*).

Përfundimet dhe Vlerësimi

GVB konkludon se programet mësimore të ofruara nga Institucioni organizohen dhe realizohen brenda kuadrit ligjor duke respektuar kushtet e nevojshme për një implementim sa më efektiv të tyre.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, Institucioni ndjek dhe vlerëson në mënyrë periodike kurrikulat dhe syllabuset, stafin akademik, duke i dhënë një rëndësi të veçantë përfshirjes së studentëve në këtë proces.

Për të realizuar një mësimdhënie të standardeve bashkëkohore, Institucioni mbështet, inkurajon dhe vlerëson zhvillimin e punës kërkimore – shkencore, duke krijuar partneritete me institucione të huaja të Arsimit të Lartë, zhvillimit të punës kërkimore të personelit akademik, organizimit të aktiviteteve të ndryshme kërkimore – shkencore, si dhe publikimit të rezultateve të kërkimit.

Aktualisht, Institucioni është i angazhuar në zgjerimin e bashkëpunimeve dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, në kuadër të programeve të ndryshme Europiane.

5 – FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi

Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj. (Kreu I Standardi III.1)

Pranimi i studentëve të rinj në Albanian University realizohet bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe Udhëzimet Ligjore në fuqi në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave, respektivisht për vitin akademik 2016-2017, VKM nr. 407 datë 01.06.2016 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”, për vitin akademik 2017-2018 Udhëzim nr. 15 datë 19.05.2017 për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018 dhe për vitin akademik 2018-2019 Udhëzim nr.26, datë 30.07.2018 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.18, datë 21.05.2018 “për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018-2019. Informacioni për kriteret, kuotat dhe procedurën e aplikimit publikohet online në faqen zyrtare <https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/>

Në përfundim të çdo viti akademik Albanian University përcakton dhe miraton (*Evidencë Nr. 3.3*) kuotat e pranimit në ciklet e ndryshme të studimeve dhe në rastet e caktuara vendos kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen dhe vihen në dispozicion për QSHA-në dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë.

Për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve në AU është ngritur Zyra e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve e cila funksionon në përputhje me rregulloren përkatëse. (*Evidencë Nr. 2.28*)

Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik. (Kreu I Standardi III.2)

"Albanian University" ka një strukturë të mirëorganizuar që siguron këshillimin e studentëve, orientimin e tyre si dhe komunikimin në nivele të ndryshme me personelin akademik.

Në nivel institucional funksionon "Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve", e cila siguron dhe mbështet orientimin dhe komunikimin e studentëve për çdo program studimi.

Universiteti ofron lehtësira të komunikimit të brendshëm të personelit akademik dhe studentëve të tij. Realizimi i tutoriatit në nivel Njësie Bazë mundëson komunikimin e drejtpërdrejtë të studentit me pedagogët e tij. (*Evidencë Nr. 5.1*) Përdorimi i internetit është një mundësi më

shumë për komunikim të brendshëm midis pedagogut dhe studentit. *(Evidencë Nr. 4.20)*

Për sa i përket komunikimit të jashtëm, universiteti ofron një numër të madh mjetesh të komunikimit si përdorimi i faqes Web të institucionit (<http://www.albanianuniversity.edu.al/>) dhe stacionin televiziv “UTV NEWS” falë marrëveshjes së bashkëpunimit (<http://www.utv-news.tv>). Mjetet dhe mënyrat kryesore të informimit dhe komunikimit me studentët në “Albanian University” janë:

- Faqja zyrtare e institucionit “Albanian University” / www.albanianuniversity.edu.al/
- Numrat e telefonit;
- Adresat e-mailit;
- Posterat e afishuara në këndet e informimit;
- Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve
- Zyra e Karrierës dhe Alumni
- Zyrën e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve;
- Sekretaria mësimore si dhe Sekretaria on-line;

Institucioni disponon adresën elektronike dhe numrin e telefonit të çdo studenti si dhe dosjen e plotë personale të studentit që menaxhohet nga Sekretaritetë mësimore dhe pas diplomimit të studentit arkivohet, duke respektuar parashikimet ligjore të vendosura nga ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në R.SH, i ndryshuar.

Gjithashtu studentët mund të komunikojnë me stafin administrativ të “Albanian University” nëpërmjet adresave elektronike të brendshme të stafit administrativ, të cilat gjenden të afishuara në Web-site të institucionit.

Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve. *(Kreu I Standardi III.3)*

AU në bashkëpunim me Zyrës e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve organizon aktivitetet e përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit për njohjen e studentëve me universitetin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit.

Kontaktet e drejtuesve dhe zyrave të Institucionit vendosen në shërbim të studentëve, së bashku me adresat elektronike publikohen në faqen zyrtare www.albanianuniversity.edu.al/sq/kontakte/.

Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve vë në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese për t’i orientuar ata për të njohur organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre nëpërmjet Manualit të Studentit. *(Evidencë Nr. 5.2)*

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta. *(Kreu I Standardi III.4)*

“Albanian University” i kushton rëndësi të vazhdueshme mbështetjes së kategorive sociale dhe bursave të studimit, si pjesë e përgjegjësisë ndaj komunitetit.

“Albanian University” ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe si dhe për

studentët nga komuniteti Rom dhe Egjiptian sipas ligjeve në fuqi dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ndjekia e procesit mësimor merr një vëmendje të veçantë në aspektin e mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të të nxënit dhe qëndrimit në klasë.

Kategoritë e bursave që ofrohen nga “Albanian University” janë: **(Evidencë Nr. 5.3)**

1. Programi i ekselencës;
2. Bursa studentë me aftësi të kufizuara;
3. Bursa Sociale;
4. Bursa për fëmijët jetimë dhe policëve të rënë në krye të detyrës;

Për studentë pjestarë të së njëjtës familje akordohen tarifa lehtësuese (bursë) për ti ardhur në ndihmë familjeve me më shumë fëmijë.

“Albanian University” ndjek një politikë mbështetëse për studentët që angazhohen në aktivitete sportive të niveleve të larta, si skuadra futbollit, basketbollit etj., duke krijuar lehtësi në ndjekjen e procesit mësimor si për shembull duke bërë konsultime për këtë grup studentësh. Gjithashtu këtij grupi studentësh, u janë vënë në dispozicion edhe ambientet sportive të “Albanian College”, të cilat shërbejnë për stërvitje apo aktivitete të tjera ekstrakurrikulare. **(Evidencë Nr.2.26)**

“Albanian University” ndjek politika të organizimit të procesit mësimor në përputhje me nevojat e kërkesave të studentëve. Kështu studentët që janë në marrëdhënie pune, grupohen në grupe të caktuara. Bazuar në kërkesat e studentëve në fillim të çdo viti akademik formohen grupe të cilët e realizojnë procesin mësimor, duke respektuar kriterin e orëve të përcaktuara në kurrikulat e programeve të studimit, gjatë orëve të pasdites ose në fundjavë.

Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët. *(Kreu I Standardi III.5)*

“Albanian University” ofron një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese. Tekstet mësimore që “Albanian University” ofron për studentët janë të miratuara nga njësitë bazë përkatëse të AU-së dhe përdoren edhe në universitete të tjera në vend apo dhe jashtë tij.

Në mjediset e AU janë vendosur tre biblioteka, të cilat shërbejnë edhe si salla studimi për studentët. Në to përfshihet literaturë me tituj të librave universitarë dhe botime artistike. Në këto biblioteka ka një numër të konsiderueshëm tituj librash, rreth 4109 tituj.

Informacione të tjera merren nga studentët nëpërmjet materialeve të dërguara online nga pedagogët, materialeve të botuara nga shtëpia botuese “AU Press”. Kjo literaturë pasurohet periodikisht nëpërmjet botimeve në Revistën “OPTIME” (Revista e Punimeve Shkencore në Universitet), abonimeve në biblioteka dhe revista online, kërkimit shkencor të pedagogëve dhe botimeve në kuadër të projekteve ndërkombëtare. **(Evidencë Nr.2.11)**

Gjithashtu, pranë departamenteve të veçanta, janë ngritur minibiblioteka të cilat ofrojnë literaturë specifike për studentët e programeve përkatëse.

Institucioni disponon shtëpinë botuese “AU Press” e cila merret me botime të literaturës bashkëkohore në funksion të programeve të ndryshme të studimit. (*Evidencë Nr. 2.12*)

Universiteti përdor fonde të veçanta për blerjen e literaturës së re që del në tregun e librave universitarë, duke pasuruar kështu bibliotekat dhe duke u krijuar lehtësira studentëve në përdorimin e saj. “Albanian University” parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e çdo Fakulteti. (*Evidencë Nr. 4.7*)

Oraret e punës së bibliotekave në AU gjatë të cilave punonjësit u përgjigjen nevojave të studentëve, shpallen në mjediset dhe në web-site të institucionit. (www.albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/) Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejojnë të marrin librat në ambientet e sallave të studimit brenda universitetit.

Aktualisht sipas Fakulteteve në bibliotekat e institucionit gjenden:

Biblioteka pranë godinës së AU, Bulevardi Zogu I-rë, që shërben dhe si sallë studimi, ka të skeduar 1972 tituj librash, libra mësimorë, artistikë dhe revista të ndryshme. Koleksioni i librave përmban po ashtu, manuale, artikuj simpoziumesh, fjalorë si dhe artikuj të ndryshëm gazetash të Universitetit. Përkatësisht 178 tituj janë literaturë në gjuhë të huaj, ndërsa rreth 1794 tituj janë literaturë në gjuhën shqipe. Tituj total periodikë 172, nga këto 104 tituj janë në gjuhë shqipe dhe 68 tituj në gjuhë të huaj.

Biblioteka në godinën e AU pranë “Rrugës së Durrësit”, e cila shërben dhe si sallë studimi dhe interneti ku studentët kanë akses dhe mundësi të zgjerimit të dijeve nëpërmjet sistemit të edukimit “on-line”, ka të skeduar rreth 1210 tituj librash, që ndahen sipas degëve, libra studimorë, akademikë, artistike, fjalorë, si dhe revista të ndryshme shkencore, literaturë e huaj, kumtesa konferencash dhe artikuj të ndryshëm gazetash të Universitetit. Përkatësisht, pranë kësaj biblioteke gjenden 346 tituj literaturë në gjuhë të huaj si dhe 632 tekste për programin e Infermierisë, 241 tekste për programin e Fizioterapisë apo 342 tekste për Farmacinë dhe 734 tekste për Stomatologjinë.

Biblioteka në godinën e AU pranë “Rrugës së Kavajës”, ka të skeduar rreth 1456 librash nga të cilat, 1125 libra janë në gjuhën shqipe dhe 340 në gjuhë të. Literatura është e regjistruar në inventarin e Bibliotekës kryesisht të degës së Arkitekturës dhe Inxhinierive, si dhe literaturë akademike, artistike, studimore, artikuj në fusha të ndryshme.

Në këtë bibliotekë gjenden gjithashtu donacione nga profesorë të shquar shqiptarë, italianë dhe nga OSBE. Pasurim tjetër të literaturës përbën edhe lidhja online me biblioteka ndërkombëtare. Në bibliotekën online www.questia.com ka rreth 83.000 libra në total. 17.662 Revista Shkencore në fushën e Mjekësisë 30.749 Gazeta në fushën mjekësore. 751 Enciklopedi Mjekësore.

Në portalin www.getty.edu ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një

sërë universitetesh në mbarë botën nga të cilat 6.400 janë vetëm mbi arkitekturën.

Ndërsa në bibliotekën online www.elsevier.com ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta. Gjithashtu në dispozicion të studentëve janë dhe libraritë on line ERIC- Education Resources Information Center dhe Cambridge Journals të cilat kanë artikuj për te gjitha programet e studimit. (www.cambridge.org/core)

Institucioni u ofron studentëve të ciklit të parë mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre. (Kreu I Standardi III.6)

“Albanian University” ofron për studentët udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) nëpërmjet departamenteve përkatëse si dhe nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. Kjo realizohet gjatë gjithë periudhës së studimeve.

Që në fillim të vitit akademik Institucioni ndihmon dhe orienton studentin për kurrikulën e programit të studimit, rëndësinë e frekuentimit, mënyrën e sigurimit të literatures gjatë viteve akademike nëpërmjet:

- Programit të lëndës, i cili i vihet në dispozicion çdo studenti që orën e parë në auditor nga pedagogu i lëndës;
- Pedagogët e tutoriatit;
- Pedagogët – në mentorim për orientimin dhe mbështetjen në përgatitjen e temës së diplomës;
- Personelit të bibliotekës;
- Sekretaritë mësimore.

Institucioni ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët e lëndëve sipas departamenteve.

Pedagogët e përcaktuar për kujdestari (tutoriat) ndihmojnë studentët gjatë fazës së përzgjedhjes të temave të diplomës, dhe nëpërmjet mentorimit deri në përfundim të ciklit të studimeve. Hulumtime shkencore të realizuara nga studentët tanë me profesorë të huaj falë bashkëpunimeve bilaterale me universitet prestigjoze janë një hov cilësor në fushën e kërkimit dhe shkencës. **(Evidencë Nr. 5.4)**

Institucioni parashikon procedura të qarta të shpërndarjes së udhëheqjeve të temave të diplomës nw pwrputhje me rregulloret e programeve të studimit. **(Evidencë Nr. 3.14, Neni 30,31,32,33 fq. 26,27)**

Ndërsa Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve në bashkëpunim me Njësitë Bazë zhvillon për studentët orë leksioni të hapura për orientimin e studentëve në punimin e temës së diplomës si dhe vë në dispozicion për studentët “Manualin për punimin e temës së diplomës”. **(Evidencë Nr. 4.6)**

Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale. (Kreu I Standardi III.7)

Studentët janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Statutit të “Albanian University” neni 49, fq.30. Këshilli Studentor i “Albanian University” (KSAU) është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve si dhe funksionon sipas një Statuti të posaçëm. **(Evidencë Nr. 5.5)**

Universiteti, mbështet edhe financiarisht në mënyrë të vazhdueshme veprimtari të veçanta të studentëve si pjesmarrje në Konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit apo evente kulturore të organizuara me universitete partnere. **(Evidencë Nr. 5.6)**

AU inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre, parashikuar kjo shprehimisht në dispozitat e Statuti të AU. **(Evidencë nr. 1.1, Neni 47, fq. 22)** Këshilli Studentor i “Albanian University” shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Përfaqësuesit e tij janë pjesë e organeve kolegjiale të Institucionit. **(Evidencë Nr. 5. 7)**

“Albanian University” në përbërje të tij ka 3 (tre) Fakultete. Çdo Fakultet i “Albanian University” ka Këshillin Studentor të tij. Çdo Këshill Studentor në nivel Fakulteti ka përfaqësuesët e tij : Mbledhja e Kryetareve – organi më i lartë vendimmarrës. Anëtarë të mbledhjes së Senatorëve janë *senatorët e zgjedhur drejtpërdrejt nga trupa zgjedhore* që mbledhet nga kryetaret si dhe Organe të tjera të cilat mund të krijohen me vendim të Mbledhjes së Këshillit dhe Autoriteteve drejtuese të projektit të “Albanian University” **(Evidencë Nr. 5.5, Neni 8,9 &18 fq.4-8)**

Senati Akademik – ka 1 përfaqësues të studentëve, Kryetarin e Këshillit Studentor të AU. Senatorët studentë të Këshillit Studentor në AU shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si: për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Ky mendim merret drejtpërdrejt nga takimet me studentët dhe nëpërmjet ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve.

“Albanian University Press” boton çdo vit punimet e studentëve pjesëmarrës në Konferencat Studentore të Fakulteteve. **(Evidencë Nr. 5.8)** Bordi i Administrimit në “Albanian University” financon çdo vit pjesëmarrjen e personaliteteve të huaja dhe vendase të fushave të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve të Klubeve Studentore. Pjesë e financimit të Bordit të Administrimit është gjithashtu dhe blerja e pajisjeve të veçanta teknologjike për nxitjen e zhvillimit të projekteve inovative të punëve laboratorike të studentëve. **(Evidencë Nr. 5.9)**

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore. (Kreu I Standardi III.8)

“Albanian University” ka në vëmendjen e tij cilësinë e jetës universitare të studentëve, pasi ky Institucion kërkon të formojë individë të aftë të cilët në të ardhmen do të jenë udhëheqës e

profesionistë të zotë duke i ardhur në ndihmë zhvillimeve kombëtare. Në mbështetje të nevojave studentore “Albanian University” ka në strukturën organizative "Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve" si dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumni të cilat kanë në funksion të tyre organizimin dhe aktivizimin e studentëve në veprimtari brenda dhe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor si dhe orientimin e vazhdueshëm të studentëve për karrierën e tyre profesionale. Një nga qëllimet e zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve është realizimi i intershipeve për praktikë profesionale apo krijimi i kontakteve me kompani dhe institucione të ndryshme. (*Evidencë Nr. 5.10*)

Gjithashtu, në mbështetje të studentëve, për zgjidhjen e problematikave emocionale apo sociale të tyre ofrohet shërbimi psikologjik pranë Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.

Studentët janë të organizuar gjithashtu në “Klubet Studentore” të AU. Ndër klubet kryesore përmendim:

Fakulteti i Shkencave të Aplikuar

1. Klubi i Marketingut & Menaxhimit
2. Klubi i Artit & Design_it
3. Klubi i Inxhinierive dhe Informatikës

Fakulteti i Shkencave Shoqërore

1. Shoqëria dhe Ligji
2. Klubi i Psikologëve
3. Klubi i Mësuesisë dhe Linguistikës

Fakulteti i Shkencave Mjekësore

1. Klubi i Stomatologëve të Rinj
2. Klubi i Farmacistëve të Rinj
3. Klubi i Infermierisë dhe Fizioterapisë

“Albanian University” bashkëpunon me strukturat shëndetësore për ndjekjen e politikave parandaluese dhe kuruese në ndihmë të shëndetit të studentëve. P.sh. ka veprimtari periodike me Kryqin e Kuq. (*Evidencë Nr. 5.11*) Një pjesë e konsiderueshme e temave të zhvilluara nga lektorët në leksionet e hapura janë diskutimet rreth kujdesit shëndesor dhe parandalimit të sëmundjeve në veçanti. (*Evidencë Nr. 5.12*)

Në kuadër të mbështetjes së studentëve, AU vitin e ardhshëm akademik do i paisë të gjithë studentët me kartën studentore, nëpërmjet së cilës do të kenë mundësi të përfitojnë shërbime nga institucione dhe kompani të ndryshme me tarifa lehtësuese.

Institucioni favorizon punësimin e studentëve. (Kreu I Standardi III.9)

AU ka ndjekur politika favorizuese të punësimit të studentëve brenda institucionit. Studentë të ekselencës janë pjesë e administrates apo stafit ndihmës pedagogjik në Albanian University. (*Evidencë Nr. 2.2*) Gjithashtu, në politikat e tij të rekrutimit, AU në rastin e shpalljeve të vendeve të lira të punës, krahas publikimit në faqen zyrtare të internetit, <https://albanianuniversity.edu.al/sq/aplikime/> njoftimin për punësim e shpërndan elektronikisht

për studentët në vitin e fundit të studimeve dhe për studentët e diplomuar.

Institucioni duke bashkëpunuar me tregun e punës, ndihmon në punësimin e studentëve të tij jo vetëm brenda AU, por edhe me punëdhënës të ndryshëm. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Zyra organizon Panairin e Karrierës një here në vit dhe ka si objektivi kryesor të sigurojë kontakte me rekrutuesit për të rritur mundësitë e punësimit. (*Evidencë Nr. 5.13*)

Aktualisht "Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve" ka 130 marrëveshje të lidhura me institucione private dhe publike për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët dhe ofrimin e vendeve të punësimit sipas disiplinave të studimit.

Zyra mban rregullisht të dhëna rreth shkallës së punësimit të studentëve sipas degëve e viteve të tyre të diplomimit. (Evidencë Nr.1.34) Studentët dhe të diplomuarit në AU kanë arritur të punësohen në kompani e institucione të rëndësishme në vend si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. "Albanian University" zhvillon aktivitete që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve.

Përfundimet dhe Vlerësimi

GVB vlerëson se AU përmbush plotësisht standardet për mbështetjen, inkurajimin dhe informimin e vazhdueshëm të studentëve për karrierën e tyre profesionale si për t'u integruar në tregun e punës. Institucioni ndjek një politikë korrekte nga regjistrimi deri tek punësimi i studentëve duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve.

Institucioni ndjek një politikë të mirë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik nëpërmjet një sistemi të mirëorganizuar tutoriatit dhe mentorimit si dhe falë mbështetjes së strukturave përkatëse të ngritura në këtë Institucion.

Albanian University i kushton rëndësi të vazhdueshme mbështetjes së kategorive sociale dhe bursave të studimit, si pjesë e përgjegjësisë ndaj komunitetit si dhe ofron një bibliotekë të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese, shfrytëzuar nga studentët për veprimtari kërkimore shkencore.

Studentët janë një zë i fortë në Albanian University të përfshirë zyrtarisht në organet kolegjiale të Institucionit.

Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm

Në përfundim të hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin institucional periodik të *Albanian University*, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm paraqet analizën përmbledhëse, si më poshtë vijon:

a. Pika të forta:

- Struktura organizative e *Albanian University* funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Bazuar në to janë përditësuar të gjitha aktet e tjera normative të institucionit.
- Institucioni ka angazhuar personel akademik të kualifikuar me grada shkencore dhe tituj akademikë, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, si dhe në përputhje me profilin përkatës.
- *Albanian University* ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit: *Bachelor*, *Master*, specializime pasuniversitare dhe Doktoratë, në përputhje me nevojat e tregut vendas dhe atij të huaj.
- *Albanian University* ofron programe të reja studimi bazuar në një analizë të mirëfilltë të tregut të punës duke angazhuar si pjesë e grupit të punës edhe ekspertë të jashtëm me përvojë në fushat përkatëse.
- Kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve janë përditësuar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, me të rejat më të fundit të tregut të punës dhe janë pasuruar me literaturë dhe publikime bashkëkohore.
- *Albanian University* bazuar në strategjinë për zhvillimin institucional, ka hartuar strategjinë për zhvillimin e kërkimit shkencor në institucion, strategjinë e zhvillimit në nivel njësie bazë, si dhe strategjitë e zhvillimit për programet mësimore, bazuar edhe në studimin e tregut të punës.
- Institucioni ka bërë përpjekje pozitive në drejtim të aplikimit dhe fitimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- *Albanian University* ofron një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë dhe ka bërë të mundur formimin e “kulturës” së cilësisë në institucion.
- Institucioni në të tre fakultetet ofron biblioteka me infrastrukturë të përshtatshme për studentët, të pasur me literaturë bashkëkohore, si dhe mundësi aksesimi në bibliotekat online.
- Institucioni ndjek politika të transparencës me stafin akademik, studentët dhe me publikun e gjerë.
- Dokumentacioni dhe mekanizmat e komunikimit janë të mirëzhvilluara dhe në ndihmë të informimit të studentëve në “kohë reale” funksionon sekretaria *online*.
- Institucioni ofron struktura mbështetëse dhe ndihmëse për studentët duke i përfshirë në proceset vendimmarrëse me qëllim përmbushjen më të mirë të nevojave të tyre.
- Shtëpia botuese AU Press përkthen dhe publikon literaturë bashkëkohore në ndihmë të procesit mësimor, si dhe mbështet publikimin e revistës shkencore

“Optime”, punimeve të konferencave, projekteve, si dhe punime dhe tekste individuale të pedagogëve.

- Burimet financiare të Institucionit paraqiten mëse të mjaftueshme për qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në të ardhmen.
- Institucioni është i pozicionuar në qendër të qytetit dhe ofron mjedise dhe infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

- Përshtatja e infrastrukturës për studentët me aftësi ndryshe.
- Pamundësia për dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademikë për personelin akademik, i cili përmbush standardet ligjore, si rezultat i pezullimit të procedurave, në pritje të daljes dhe vënies në zbatim të akteve nënligjore përkatëse.

c. Mundësitë:

- Ndërtimi i një kampusi bashkëkohor në qendër të Tiranës.
- Krijimi i strukturave specifike për dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademik në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.

d. Pengesat:

- Ndërtimi i kampusit ka si pengesë vështirësitë administrative dhe proceduriale për marrjen e lejes si rezultat i mosvendimmarrjes në kohë reale nga pushtetit vendor.
- Mungesa e riorganizimit të strukturave në nivel kombëtar për dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Lista e evidencave mbështetëse të RVB – Albanian University

- R.1.a. Rekrutimi i personelit akademik për v.a. 2017-2018 dhe 2018-2019
- R.1.b. Lista e personelit akademik që është financuar nga AU
- R.1.c. Kontratat e personelit akademik
- R.1.d. Booklet – analizë pyetësori personeli akademik
- R.1.e. Lista e pedagogëve që kanë përfituar mobilitet
- R.1.f. Analizë e qëndrueshmërisë së personelit akademik
- R.2.a. Trajnimi i personelit akademik me profesorë të huaj
- R.2.b. Shkresat MASR – miratim i ndryshimeve në programe
- R.2.c. Lista e marrëveshjeve me IAL të huaja
- R.2.d. Lista e konferencave të realizuara në bashkëpunim me IAL të huaja
- R.2.e. Lista e studentëve që kanë përfituar mobilitet
- R.2.f. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikat profesionale
- R.2.g. Lista e marrëveshjeve me IAL kombëtare
- R.3.a. Vendim Rektorati për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e strategjisë KSH
- R.3.b. Strategjia për kërkimin shkencor
- R.4.a. Vendimi i Rektoratit për temat kërkimore – shkencore në njësitë bazë
- R.4.b. Lista e temave kërkimore – shkencore sipas njësive bazë
- R.4.c. Model procedure për temën kërkimore shkencore

Fusha 1 – Organizimi dhe menaxhimi i institucionit

- 1.1. Statuti AU
- 1.2. Vendim Senati për miratimin e statutit
- 1.3. Shkresë MAS për miratimin e statutit
- 1.4. Rregullore e Përgjithshme AU
- 1.5. Vendim Senati për miratimin e rregullores së përgjithshme të ndryshuar
- 1.6. Rregullore Senati Akademik
- 1.7. Rregullore Rektorati
- 1.8. Rregullore Bordi i Administrimit
- 1.9. Rregullore NjSBC
- 1.10. Vendim Senati për ngritjen e Komisionit për Vlerësim Institucional
- 1.11. Vendim Senati për ngritjen e NJSBC-së
- 1.12. a. Vendim Senati për ngritjen e GSC në nivel njësie bazë

- b. Lista e GSC –në nivel njësie bazë
- 1.13. a. Vendim i Bordit të Administrimit për ekspert të Zyrës së Zhvillimit të kurrikulave
- b. Vendim i Bordit të Administrimit për ekspert juridik
- c. Vendim i Bordit të Administrimit për ekspert të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë
- d. Marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Juridike
- 1.14. Projekti GRADUA
- 1.15. Projekti HYPOSENSE
- 1.16. Projekti me Arkivat e shtetit
- 1.17. Projekti me Kuvendin e Shqipërisë
- 1.18. Lista e aplikimeve në projekte
- 1.19. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022
- 1.20. Vendim Senati për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit Institucional
- 1.21. Plani i masave të marrë në kuadër të strategjisë
- 1.22. Raport Vjetor AU
- 1.23. Udhëzimi Nr. 5 i MASR, dt. 19.02.2018
- 1.24. Vendim Senati për miratim e Raporti Vjetor AU
- 1.25. Shkresë e dërgimit të Raportit Vjetor në MASR
- 1.26. Organogramë AU
- 1.27. Broshura e ofrimit të programeve cikli I, II dhe III
- 1.28. Lista e personelit akademik
- 1.29. Lista e studentëve të përfshirë në organet kolegjiale
- 1.30. Model analize e tregut të punës
- 1.31. Miratim i grupit të punës për hartimin e programit dhe studimin e tregut të punës
- 1.32. Urdhëra MASR për hapjen e programeve të reja v.a. 2018-2019
- 1.33. Lista e programeve të reja të aplikuara në MASR
- 1.34. Të dhëna mbi punësimin e studentëve që kanë mbaruar në AU
- 1.35. Vendim Senati për tarifën e studimit
- 1.36. Strategjia e partneritetit dhe komunikimit
- 1.37. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare
- 1.38. Lista e studentëve jashtë Republikës së Shqipërisë
- 1.39. Lista e profesorëve të huaj të angazhuar në mësimdhënie pranë AU

Fusha 2 – Burimet

- 2.1.a Kontratë UTV Education & AU
- 2.1.b AU Vende vakante 2017-2018
- 2.1.c AU Vende vakante 2018-2019
- 2.2 Lista emërore e të punësuarve në AU të cilët janë diplomuar në AU
- 2.3 Kontratë Personel Administrativ
- 2.4 Personeli akademik i punësuar në Albanian University i arsimuar jashtë vendit
- 2.5 Agjenda e trajnimeve për stafin akademik, 2017-2018
- 2.6.a Agjenda e trajnimeve për stafin administrativ
- 2.6.b Trajnim stafi administrativ mbi sekretarinë online
- 2.7.a Poster Open Day 2019
- 2.7.b Open-Day-Dentistri 2019
- 2.7.c Ditët e Informimit Master Inxhinieri
- 2.7.d Ditët e Informimit Shkencat Shoqërore
- 2.7.e Ditët e Informimit Programet master FShM
- 2.7.f Ditët e Informimit programi Interier Dizajn
- 2.7.g Material informues “Open Day”
- 2.7.h Broshurë informuese Programi Stomatologji
- 2.8.a Aktivitete ekstrakurrikulare v.a. 2017- 2018
- 2.8.b Aktivitete ekstrakurrikulare v.a. 2018-2019
- 2.9.a Lista e konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare
- 2.9.b Model Konferenca Shkencat Mjekësore.
- 2.9.c Model Konferenca Shkencat Shoqërore
- 2.9.d Model Konferenca Shkencat e Aplikuara dhe Ekonomike
- 2.9.e Model Konferenca Studentore
- 2.10.a Procedure financimi Projekti Colomed
- 2.10.b Procedure financimi Personel Akademik
- 2.11 Model Optime Nr.2 Dhjetor 2018

- 2.12 Lista e botimeve Albanian University Press
- 2.13 Vlerësimi i performancës së stafit nga drejtuesi i Njësië Bazë
- 2.14.a Marrëveshje bashkëpunimi Univ. Federico II, Napoli
- 2.14.b Marrëveshje Bashkëpunimi Univ. Pisës, Itali
- 2.14.c Marrëveshje Bashkëpunimi Univ. Foggia, Itali
- 2.15 Bordi Drejtues i revistës OPTIME
- 2.16.a Marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar
- 2.16.b Aktivitete me karakter human
- 2.17 Dokumentacioni që përmban dosja e punëmarrësit
- 2.18 Projektbuxheti 2019-2021
- 2.19 Praktika për miratimin e buxhetit 2019
- 2.20 Rregullore e funksionimit të faqes Web
- 2.21.a Kontratë Qiraje Bulevardi Zogi i I (Ish estrada)
- 2.21.b Kontratë Qiraje Rruga e Durrësit (Ish gjykata II)
- 2.21.c. Kontratë Qiraje Rruga e Durrësit (Ish gjykata I)
- 2.21.d Kontratë Qiraje (Internacionali I)
- 2.21.e Kontratë Qiraje (Internacionali II)
- 2.21.f. Kontratë Qiraje rr. Kavajës
- 2.22.a Planimetri Godina në Bulevardin Zogu I - Ish Estrada
- 2.22.b Planimetri Godina në Rrugën e Durrësit - Ish Gjykata (FSHM)
- 2.22.c Planimetri Godina në Rrugën K. Karafili - Internacionali (FSHM)
- 2.22.d Planimetri Godina në Rrugën e Kavajës
- 2.22.e Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore
- 2.23 Rregullore e Zyrës së Arshivës dhe Protokollit
- 2.24 Lista e figurave akademike të nderuara
- 2.25. Lista e Laboratorëve, AU
- 2.26 Marrëveshje bashkëpunimi me Albanian College Tiranë

2.27 Shkresë drejtuar MASR mbi kuotat e pranimit 2019-2020

2.28 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve

Fusha 3 – Kurrikula

3.1 Vendim Senati për listën e programeve aktive

3.2 Manifesti akademik

3.3 Vendim Senati për miratimin e kuotave dhe kritereve të kandidatëve për student

3.4 Aktivitete në kuadër të informimit të maturantëve

3.5 Çertifikatë e programit të “Edukim në vazhdim” ofruar nga AU

3.6 Shkresë - Fitimi i statusit të ofruesit të akredituar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim

3.7 Raporti i Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave 2018-2019

3.8 Procedure e rishikimit të kurrikulës

3.9 Rregullore për mbarëvajtjen e Kurrikulave

3.10 Procedurë rishikimi i syllabuseve

3.11 Vendim Senati përbërja e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin

3.12 Vendim Senati për ngarkesën mësimore të personelit akademik

3.13 Model i plotësuar syllabusi

3.14 Rregullore programi studimi Msc. Stomatologji (Program i Integruar)

3.15 Rregullore programi studimi Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor

3.16 Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve

3.17 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni

3.18 Rregullore programi studimi Mp. Qeverisje dhe Administrim Publik

3.19.a Model suplementi

3.19.b Listë notash

3.20 Njoftim mbi ofrimin e kursit të gjuhës gjermane

3.21 Model Vendim Komisioni për Njohje të krediteve të fituara në një IAL tjetër

3.22 Lista e studentëve të transferuar në AU gjatë 2 viteve të fundit

Fusha 4 – Mësimdhënia, Mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi

- 4.1 Procedurë hartimi i programit të ri të studimit
- 4.2 Model Rregullore, Njësia Bazë
- 4.3 Marrëveshje për praktikën profesionale “Gjykata e Shkallës së Parë”, Rrethi Gjyqësor, Tr.
- 4.4 Procedurë e ndjekur për praktikën profesionale në programin Msc. “Farmaci”
- 4.5 Procedurë e ndjekur për mbrotjen e diplomës në programin Msc. “Farmaci”
- 4.6 Manual për përgatitjen e diplomës
- 4.7 Procedurë pasurimi e bibliotekës
- 4.8 Lista e librave në bibliotekë
- 4.9 Lista e librave online
- 4.10 Rregullore e Sekretarisë mësimore
- 4.11 Raport Vjetor Njësia Kryesore
- 4.12 Raport Vjetor Njësia Bazë
- 4.13 Shembull - raport semestral i personelit akademik
- 4.14 Shembull - formular i kërkimit-shkencor
- 4.15 Model pyetëtori i studentëve
- 4.16. a. Evidencë mbi focus grupet,
b. Kalendar aktivitetesh NjSBC
- 4.17 Model ngritje e grupit të ekspertëve për rishikimin e kurrikulave
- 4.18 Raport vjetor – NjSBC
- 4.19 Sistemet e menaxhimit të informacionit në shërbim të mësimdhënies
- 4.20 Shembuj – përdorimi i Google Classroom
- 4.21 Lista e personelit që ndjek studimet e ciklit të III-të
- 4.22 Të dhënat e publikimeve të personelit akademik
- 4.23 Kërkesa për financim “Doku.tech”
- 4.24 Marrëveshje bashkëpunimi “Akademia e Shkencave”
- 4.25 Marrëveshje bashkëpunimi “Akademia e Studimeve Albanologjike”

- 4.26 Shembull evidence për mobilitet
- 4.27 Informacion stafi i angazhuar në GRADUA
- 4.28 Lista me anëtarët e personelit të cilët janë mbështetur për studimet doktorale në Itali
- 4.29 Rregullore Zyra e Kordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike
- 4.30 Raport i Zyrës së Kordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike

Fusha 5 – Studentët

- 5.1 Model tutorati i studentëve
- 5.2 Manual i studentit
- 5.3 Tabelë përmbledhëse mbi bursat e studimit të ofruara
- 5.4 Temat e diplomës të udhëhequra nga profesorë të huaj
- 5.5 Statuti i Këshillit Studentor
- 5.6 Shembull, financimi i studentëve
- 5.7 Vendim Senati për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale
- 5.8 Abstrakt book konferenca studentore (a, b, c, d)
- 5.9 Klinika & laboratorët – investimet
- 5.10 Klinika Bavaria, Gjermani
- 5.11 Trajnim Kryqi i Kuq Shqiptar
- 5.12 Poster leksione të hapura
- 5.13 Panairi i punës

Evidenca Extra

- E.1.a Syllabuse Msc. Stomatologji (Program i Integruar)
- E.2.a Rregullore Mp. Infermieri Kirurgjikale
- E.2.b Syllabuse Mp. Infermieri Kirurgjikale
- E.3.a Rregullore SPA Ortognatodonci
- E.3.b Syllabuse SPA Ortognatodonci
- E.4.a Syllabuse Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor
- E.5.a Syllabuse Mp. Qeverisje dhe Administrim Publik

- E.6.a Rregullore Msc. Psikologji Klinike
- E.6.b Syllabuse Msc. Psikologji Klinike
- E.7.a Rregullore Bsc. Menaxhim Biznesi
- E.7.b Syllabuse Bsc. Menaxhim Biznesi
- E.8.a Rregullore Mp. Interier Dizajn
- E.8.b Syllabuse Mp. Interier Dizajn
- E.9.a Rregullore Msc. Inxhinieri Elektronike
- E.9.b Syllabuse Msc. Inxhinieri Elektronike
- E.10 Rregullore Fakulteti i Shkencave mjekësore
- E.11 Model plani strategjik i programit të studimit
- E.12 Model plani strategjik Njësisë bazë
- E.13 Kodi i Etikës